



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ANALIZA VJETORE E PERFORMANCËS VITI 2021

Në mbështetje të shkronjës “b” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku përcaktohet se: “Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i paraqet Ministrit të Drejtësisë raporte mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike”, u hartua raportimi për vitin 2021.

Ky raport përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga ligji nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë si dhe dokumentat strategjke në të cilat DNJF është e përfshirë, të ndara respektivisht sipas kërreëve.

Tabela e Përmbajtjes

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.....	4
1.1 Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	4
2. Ndhma Juridike Parësore	5
2.1 Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndhmës juridike parësore	6
i. Objektiv, hapja e 4 qendrave të reja me mbështetjen e UNDP për vitin 2022 dhe kalimi me mbështetjen e buxhetit të shtetit të 2 qendrave për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.....	7
2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndhmës juridike parësore.....	9
2.3 Financimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.....	13
2.4 Të dhënat statistikore për vitin 2021, ndhma juridike parësore.....	15
3. Ndhma juridike dytësore.....	19
3.1 Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët	19
3.2 Trajnimi i avokatëve pjesë e listës.....	20
3.3 Ecuria e vendime për pranimin e ndhmës dytësore	20
3.4 Caktimi i Avokatëve.....	24
4. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndhmës parësore dhe dytësore	26
4.1 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndhmës parësore (Janar-Dhjetor 2021).....	26
4.2 Analizë e raporteve të monitorimit	27
4.3 Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave.....	28
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë	29
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnje.....	30
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës.....	31
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër	33
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë	35
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë.....	37
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec.....	39
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë.....	41
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier	43
Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Dibër	45
5. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndhmës juridike.....	45
5.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjëse.....	46
5.2 Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndhmës juridike, edukimit ligjor të publikut ⁵²	
5.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimprurëse që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.....	52
6. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndhmës juridike parësore dhe dytësore.....	53

6.1 Bashkëpunimi me Euralius.....	53
6.2 Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (bashkëpunimi me ASPA, DHASH dhe UNDP)	54
Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore	54
Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore	54
6.3 Zhvillimi i Webinareve nga DNJF.....	55
6.4 Trajnimi i paraligjorëve në kuadër të projektit “Angazhimi proaktiv i paraligjorëve në kuadër të forcimit të aksesit në drejtësi për kategoritë vulnerabël”, me mbështetës OSFA	56
7. Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike	56
7.1 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).	56
7.2 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND).....	57
7.3 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK).....	58
7.4 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM)	58
7.5 Kontribut i DNJF në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP).	58
8 Angazhimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të procesit të Integritetit Europian dhe Raportimeve Ndërkombëtare	59
9 Raportime ndërkombëtare:	59
10 Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA:	59
11 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse (UNDP/EURALIUS/OSFA).....	60
11.1 Bashkëpunimi me UNDP.....	60
11.2 Bashkëpunimi me Euralius.....	61
11.3 Bashkëpunimi me OSFA.....	61
11.4 Bashkëpunimi me OSBE.....	62
11.5 Kërkesë për mbështetje ambasadave me qëllim forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas.....	62
12.1 Prokurimet	64
Të dhëna buxhetore viti 2021.....	64
PËRFUNDIME	68
Vështrim krahasimor	70
Arritjet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas 2020- 2021	70
Plani i Punës së DNJF (Janar-Dhjetor 2021)	73

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër nr. 59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndihmës Juridike Falas” me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në Shkurt të vitit 2021, është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundur kështu realizimin e këtij objekti në masën 100%.

Gjithashtu, sa i përket procedurave të rekrutimit të stafit ekzekutiv, përgjatë tre muajve të parë të vitit 2021, është plotësuar vendi vakant i specialistit të financës, të Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Aktualisht, vijojnë të mbeten vakante, pozicionet e punës për 1 Specialist Burime Njerëzore dhe 2 Specialistë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike. Ndërkohë që 1 specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike është transferuar përkohësisht pranë Ministrisë së Drejtësisë për nevojë emergjente pune të Drejtorisë Antikorrupsion pranë Ministrisë së Drejtësisë.

3 (tre) vakancat pranë Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike kanë bërë që punonjësit e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore të ngarkohen përkohësisht me detyra të Drejtorisë së Mbikëqyrjes përpos detyrave shpesh në cilësinë e anëtarëve të grupit të prokurimeve/ marrjes në dorëzim të mallrave/ inventarizimit etj. Raporti ndërmjet volumit të punës dhe numrit të ulët të punonjësve ndikon drejtpërdrejtë në kohën dhe në cilësinë e punës së kryer nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Me qëllim evitimin e kësaj problematike, Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas i është drejtuar në mënyrë të përsëritur Departamentit të Administratës Publike me qëllim shpalljen e pozicioneve të lira në faqen zyrtare të DAP. Përgjatë vitit 2021, vendet vakante nuk janë shpallur në faqen zyrtare të DAP.

Sa i përket punonjësve me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, janë rekrutuar 7 punonjës pranë qendrave Lezhë, Vlorë, Fier, Dibër dhe Tiranë si dhe është bërë i mundur rekrutimi i 2 paraligjorëve të angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë (në kuadër të projektit me OSFA).

1.1 Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit, (MoU) dhe Letrës së Dakordësisë (LoA) të dakordësuar mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë së Drejtësisë mbi zbatimin e projektit “Zgjerimi i shërbimeve të Ndhmës Juridike Falas për gratë dhe burrat në shqipëri” ku përcaktohet: “Në këtë kontekst, përmes Marrëveshjes së re Standarde midis PNUD dhe MD, MD/DNJF mbeten të angazhuara të sigurojnë ofrimin e pandërprerë të shërbimeve të NJF në 8 qendrat ekzistuese të NJF për periudhën korrik - dhjetor 2021, me angazhimin e DNJF për të financuar dhe menaxhuar me fonde shtetërore të paktën tre deri në katër nga qendrat ekzistuese të NJF (të mbështetura aktualisht nga PNUD) në gjysmën e dytë të 2022 (korrik - dhjetor) dhe pjesa tjetër e qendrave ekzistuese për 2023” Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në projekt-buxhetin afatmesëm ka kërkuar shtimin e numrit të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore pjesë e strukturës së DNJF.

Një Qendër e Shërbimit të Ndhmës Juridike, duhet të ketë minimalisht 2 punonjës ku nga sa referuar marrëveshjes për financimin e 4(katër) Qendrave planifikohen 8 punonjës shtesë në Strukturën e DNJF-së

Duke qënë se Programi Buxhetor Afatmesëm hartohet cdo vit për një periudhë 3 vjeçare, janë reflektuar ndryshimet e mundshme në strukturë për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 në varësi të zbatimit të projektit dhe si ecurisë së punës në Qendrat e Ndhmës Juridike në rrethe, do të reflektohen ndryshime në PBA pasardhëse.

Gjithashtu, në strukturën aktuale të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, është planifikuar për shtesë në strukturë dhe një punonjës IT në zbatim të VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare Të Shqipërisë Së Informacionit”, i ndryshuar.

DNJF ka aplikuar për tu pajisur me një punonjës IT në zbatim të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës program i cili është krijuar për të aftësuar studentët të cilët nuk kanë përvojë pune, me qëllim zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale, akademike, personale dhe të njihen me sistemin e Administratës Publike sipas procedurës në zbatim të Urdhrit nr. 108, datë 24.05.2021 për “Metodologjia dhe Plani i Veprimit në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës, Thirrja e Gjashtë”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, procedurë e cila ka rezultuar pa fitues në të dyja fazat e saj. Drejtoria e Ndhmës Juridike përvec mirëmbajtjes së sistemit kompjuterik të institucionit duhet të menaxhojë dhe funksionimin e kompjuterave dhe sistemeve në Qendrat e Ndhmës Juridike në rrethe. Shihet si domosdoshmëri urgjente shtimi në organikë i këtij pozicioni pune.

2. Ndhma Juridike Parësore

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF. Përgjatë kësaj periudhe DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA apo EURALIUS me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

2.1 Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në kompetencën e caktuar në nenin 8, pika gj) DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF ka vijuar me procedurat e hapjes së qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytete të cilat, kanë më shumë nevoja për këtë natyrë shërbimi.

Aktualisht DNJF administron 10 (dhjetë) qendra në qytetin e Tiranës; Durrësit, Fierit, Lezhës, Shkodrës, Lushnjes, Pogradecit, Gjirokastrës, Vlorës dhe Dibrës, sipas tabelës si vijon:

Qendra	Hapur/Rivitalizuar	Vendndodhja	Mbështetës
Tiranë	Korrik 2021	Ministria e Drejtësisë	Buxhet Shteti
Durrës	Dhjetor 2020	Gjykata e Rr.Gj.Durrës	UNDP/ADA
Fier	Shkurt 2021	ADISA Fier	UNDP/ADA
Lezhë	Dhjetor 2020	Bashkia Lezhë	UNDP/ADA
Lushnje	Shtator 2020	Bashkia Lushnje	Buxhet Shteti
Gjirokastrë	Dhjetor 2020	ADISA Gjirokastrë	UNDP/ADA
Shkodër	Shkurt 2021	Gjykata e Rr. Gj. Shkodër	UNDP/ADA
Pogradec	Tetor 2020	Bashkia Pogradec	UNDP/ADA
Vlorë	Mars 2021	Bashkia Vlorë	UNDP/ADA

Përgjatë vitit 2021 është bërë e mundur hapja/rivitalizimi i 3 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier, Vlorë dhe Dibër (me mbështetjen e UNDP). Miratuar me Urdhër nr. 82 datë 19.02.2021, të Ministrit të Drejtësisë.

Nga ana e DNJF janë ndërmarrë masat për lidhjet e marrëveshjeve “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshtim për hapjen e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore”

me institucionet ku janë vendur këto qendra si dhe rekrutimit të punonjësve me trajnim të posaçëm, sipas praktikës së konsoliduar të ndjekur përgjatë vitit 2020.

Konkretisht përgjatë vitit 2021, janë lidhur 3 marrëveshje bashkëpunimi për vendosjen në dispozicion të ambienteve për Qendrat Fier, Vlorë dhe Dibër si vijon:

1. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas “Për vendosjen në dispozicion pa kundërshtim të ambienteve për hapjen e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore” dt. 05.01.2021;
 2. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Vlorë “Për vendosjen në dispozicion pa kundërshtim të ambienteve për hapjen e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore” dt. 20.04.2021;
 3. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Agjencisë së Integruar ADISA “Për vendosjen në dispozicion pa kundërshtim të ambienteve për hapjen e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore” dt. 09.01.2021.
- i. Objektiv, hapja e 4 qendrave të reja me mbështetjen e UNDP për vitin 2022 dhe kalimi me mbështetjen e buxhetit të shtetit të 2 qendrave për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.

Siç u parashtrua më sipër, në mbështetje të Marrëveshjes për zbatimin e projektit, “*Shtrirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri*” midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), si dhe në zbatim të Letrës së Bashkëpunimit (Korrik 2020-Maj 2022), është bërë e mundur hapja dhe kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas i 8 (tetë) qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Në vijim të performancës së lartë të treguar nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe me qëllim vijimësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve nga ana e UNDP dhe Ministrisë së Drejtësisë është shprehur **dakordësia për vijimësinë e mbështetjes për vitin 2022 (Marrëveshja Shkurt 2022-Janar 2023)**. Nga ana e UNDP përmes kësaj marrëveshje ndërmerret angazhimi jo vetëm për vijimin e mbështetjes së qendrave aktuale por edhe për hapjen e 4 Qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore, me kushtin që DNJF të kalojë si pjesë të strukturës së saj të 2 nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të hapura më mbështetjen e UNDP.

Referuar performancës vjetore si dhe impaktit në kuadër të ndryshimeve që passjell harta e re gjyqësore, Qendrat e evidentuara për të kaluar si pjesë e strukturës së DNJF janë Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në **Shkodër** dhe **Durrës**.

Sa i përket hapjes së qendrave të reja, me qëllim zbatimin e parimit “*1 qendër në çdo qark*” janë evidentuar si qytete me më shumë nevoja Berati, Elbasani, Kukësi dhe Korça. Hapja e tyre është miratuar paraprakisht me urdhrin nr. 517, datë 08.09.2021, të Ministrit të Drejtësisë.


Sa më sipër, **përgjatë vitit 2022** do të mundësohet rritja e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike parësore nga 10 në **14 qendra**, 4 prej të cilave do të jenë pjesë e strukturës së DNJF dhe 10 prej të cilave do të vijojnë funksionimin me mbështetjen e UNDP.

Një projeksion paraprak i qendrave për vitin 2022, parashtrohet si më poshtë vijon:

	Qendra	Hapur/Rivitalizuar	Vendndodhja	Mbështetës
1	Tiranë	Korrik 2021 MD	Ministria e Drejtësisë	Buxhet Shteti
2	Durrës	6 majori i parë 2022	Gjykata e Rr.Gj.Durrës	Buxhet Shteti
3	Fier	Shkurt 2021	ADISA Fier	UNDP/ADA
4	Lezhë	Dhjetor 2020	Bashkia Lezhë	UNDP/ADA
5	Lushnje	Shtator 2020	Bashkia Lushnje	Buxhet Shteti
6	Gjirokastrë	Dhjetor 2020	ADISA Gjirokastrë	UNDP/ADA
7	Shkodër	6 majori i parë 2022	Gjykata e Rr. Gj. Shkodër	Buxhet Shteti
8	Pogradec	Tetor	Bashkia Pogradec	UNDP/ADA
9	Vlorë	Mars 2021	Bashkia Vlorë	UNDP/ADA
10	Dibër	Shkurt 2021	Gjykata e Rr. Gj. Dibër	UNDP/ADA
11	Berat	6 majori i parë 2022	Për tu dakordësuar	UNDP/ADA
12	Korçë	6 majori i dytë 2022	Për tu dakordësuar	UNDP/ADA
13	Kukës	6 majori i parë 2022	Për tu dakordësuar	UNDP/ADA
14	Elbasan	6 majori i dytë 2022	Për tu dakordësuar	UNDP/ADA

Me hapjen e këtyre 4 (katër) qendrave të reja do të mundësohet mbulimi me ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore në 100% të territorit të Republikës së Shqipërisë sipas qarqeve.

Harta e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore



2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “*Klinikë ligjore*” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 11 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin Marin Barleti*”;
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me *Fakultetin e Drejtësisë*;
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Bedër*”;
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Wisdom*”;
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin European të Tiranës*”;
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Aleksandër Moisiu Durrës*”;
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Ismail Qemali Vlorë*”;
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Qiriazi*”;
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (*Klinika e Ligjit Shkodër*);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin Marin Barleti*”.
11. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin Luarasi*”.

Përgjatë vitit 2021, është bërë e mundur lidhja e 2 marrëveshjeve të bashkëpunimit si vijon:

- Marrëveshje Bashkëpunimi “Për dhënien e ndihmës juridike parësore” midis Universitetit “Marin Barleti” dhe Ministrisë së Drejtësisë me nr. 394 prot., dt. 21.01.2021;
- Marrëveshje Bashkëpunimi “Për dhënien e ndihmës juridike parësore” midis me Universitetit “Luarasi” dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me nr. 906 prot., dt. 12.11.2021.

DNJF ka patur një kontakt të vazhdueshëm me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit në kuadër të zhvillimit të takimeve/trajnimeve si dhe angazhimit të studentëve në praktika 3 mujore pune pranë DNJF dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, të parashtruara konkretisht si vijon:

1. *Aktiviteti “Garantimi i ndihmës juridike parësore nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve”, me pjesëmarrjen e ish-Ministrit të Drejtësisë; studentëve dhe përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit. (Janar 2021)*

Më datë 26.01.2021, u zhvillua takimi i përbashkët me të gjithë përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit dhe studentët e angazhuar pranë këtyre Klinikave.

Ky takim u hap me fjalën e ish-Ministrit të Drejtësisë e cila u shpreh mbi rëndësinë e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore, të cilat shërbejnë për informimin e qytetarëve për legjislacionin shqiptar, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, por edhe çështje të cilat lidhen me ndërmjetësimin, këshillimin, përpilimin e akteve, përfaqësimin pranë organeve të administratës shtetërore si dhe shërbime të tjera. Takimi vijoi me ndërveprimin ndëraktiv të përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit si dhe studentët të cilët shfaqën një interes të lartë sa i përket zhvillimit të trajnimeve dhe angazhimit në praktikën e punës me qëllim përfitimin e njohurive më praktike mbi sistemin e ndihmës juridike parësore.

2. *Vizitë pranë Klinikës së Ligjit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës me pjesëmarrjen e Zv.Ministrit të Drejtësisë, Z.Karameta. (Shkurt 2021)*

Zv.Ministri i Drejtësisë Z. Klajd Karameta dhe ekipi i Drejtorisë së Përgjithshme të Ndihmës Juridike inspektuan Klinikën e Ligjit pranë këtij Universiteti për të parë nga afër veprimtarinë këtij institucioni që është krijuar si risi. Në këtë vizitë, u zhvillua dhe një takim edhe me Dekanin e këtij Universiteti, takim në të cilin u prezantuan arritjet e deritanishme të kësaj Klinike si dhe bashkëpunimin më tej me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

3. *Trajnim i studentëve të angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (Shkurt 2021)*

Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Në këtë takim online u trajtuan temat: *“Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë”*.

Në fund të këtij aktiviteti studentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

4. Hapja e thirrjes për zhvillimin e praktikave të punës pranë DNJF dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Mars 2021)

Në kushtet kur për shkak të masave kufizuese të COVID-19 fakultetet vijuan të operonin online rrjedhimisht dhe Klinikat e Ligjit pranë këtyre fakulteteve u mbyllën. Kjo gjë ndikoi në uljen e rasteve të trajtuara nga Klinikat dhe pamundësinë objektive të studentëve për tu angazhuar.

Duke marrë në konsideratë interesin e madh të studentëve por edhe rekomandimet e përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit për të rritur bashkëpunimin me studentët, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas hapi thirrjen për zhvillimin e praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë Institucionit dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

Theksojmë se përditësimi i njohurive të studentëve është një ndër detyrat funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 111/2017, dhe konkretisht në nenin 16 ku percaktohet se: *“Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore”*.

Në total shprehën interesin 34 studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit “Mesdhetar”, Wisdom, Qiriazi, Universiteti “Aleksandër Mojsiu Durrës”, Universiteti “Luigj Gurakuqi Shkodër”, Universiteti “Marin Barleti”, të cilët sipas një grafiku të mirëpërcaktuar patën mundësinë të angazhohen në veprimtarinë e përditshme të Qendrave dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një mentori, pjesë e stafit të Drejtorisë dhe Qendrave.

Kjo praktikë sebashkëu me trajnimet e zhvilluara do të shërbejnë si një hallkë paraprake në mënyrë që kur Klinikat e Ligjit të vijojë ushtrimin e funksionimit me kapacitete të plota, studentët të kenë përfituar paraprakisht njohuritë bazë praktike për ofrimin e shërbimit. Përgjatë praktikës 3 mujore, studentët patën mundësinë të shohin nga afër ofrimin e ndihmës juridike falas direkt tek qytetarët.

5. Ceremonia e shpërndarjes së certifikave nga ish-Ministri i Drejtësisë, për studentët që përfunduan me sukses praktikën 3 mujore të punës (Qershor 2021)

Më datë 17.06.2021, pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për studentët që përfunduan me sukses praktikën 3 mujore të punës pranë Drejtorisë

së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Përgjatë këtij takimi Zj. Ministre e Drejtësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas patën një bashkëbisedim me studentët me qëllim ndarjen e eksperiencës së akumuluar gjatë praktikave dhe evidentimit të nevojave për përmirësim.

6. Aktiviteti, inagurimi i Klinikës së Ligjit Shkodër, tashmë me një vendndodhje të re pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (Qershor 2021)

Më datë 14.06.2021, u zhvillua Ceremonia e hapjes zyrtare të Klinikës së Ligjit pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi Shkodër”. Instalimi i zyrës së Klinikave të Ligjit në mjediset e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, shënon një moment të rëndësishëm për krijimin e mundësive të mëdha për vijueshmërinë dhe qendrueshmërinë e misionit të Klinikave të Ligjit dhe impaktit të projektit të zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë me mbështetjen e “LevizAlbania”, projektit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

7. Aktiviteti, inagurimi i Klinikës së Ligjit pranë Universitetit Luarasi (Nëntor 2021)

Më datë 12.11.2021, u zhvillua Ceremonia e hapjes zyrtare të Klinikës së Ligjit pranë Universitetit Luarasi. Ky takim u hap me fjalën e Drejtorit të Përgjithshëm i cila u shpreh mbi rëndësinë e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Takimi vijoi me ndërveprimin ndëraktiv të përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit si dhe studentët të cilët shfaqën një interes të lartë sa i përket zhvillimit të trajnimeve dhe angazhimit në praktikën e punës me qëllim përfitimin e njohurive më praktike mbi sistemin e ndihmës juridike parësore.

8. Takim me fokus fuqizimin e klinikave të ligjit si ofrues të ndihmës juridike parësore, me mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri (Nëntor 2021)

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri zhvilloi në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut tryezën me fokus fuqizimin e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të ndihmës juridike parësore.

Në këtë takim vlen të evidentojmë pjesëmarrjen e z. Maclean, Shefi në detyrë i Departamentit të Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut, Zj. Vorpsi, Zj. Bano dhe Z. Kosta, të cilët ndanë me pjesëmarrësit eksperiencat e tyre në fushën e së drejtës dhe sidomos në fushën e ndihmës juridike.

Diskutuan mbi rolin e Klinikave të Ligjit me përfaqësuesit e Klinikave në kuadër të forcimit të bashkëpunimit, shtrirjen më tej të urave të bashkëpunimit dhe në evidentimin e problematikave dhe mënyrën sesi mund ti zgjidhim ato. Studentët e pranishëm ndanë eksperiencat e tyre konkrete nga angazhimi i tyre në Klinikat e Ligjit pranë Fakulteteve të Drejtësisë duke treguar raste nga praktika, arritjet e tyre dhe falenderimet për njohuritë e marra.

Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i kapaciteteve të Klinikave të Ligjit, pjesë në mekanizmin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si një mundësi koordinimi midis tyre, me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas apo me aktorë të tretë dhe më e rëndësishmja, nxitja e studentëve të

Fakulteteve të Drejtësisë për të qenë pjesë e mekanizimit të ndihmës juridike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vlerëson maksimalisht angazhimin dhe seriozitetin e Klinikave të Ligjit dhe shpresojmë që gjatë këtij viti të vijojmë me forcimin e bashkëpunimit.

2.3 Financimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.

Bazuar në nenin 15, pika 3 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje.

Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen në VKM Nr.110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.

Në muajin Mars të vitit 2021, u hap thirrja e parë për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Në përfundim të kësaj thirrje, rezultoi të kishin aplikuar 10 (dhjetë) organizata jofitimprurëse të autorizuara. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve nga Komisioni i Vlerësimit dhe Komisioni i Ankimit, me anëtarë nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, rezultoi të mos kishte asnjë fitues nga aplikantët¹.

Për shkak se procesi nuk konkludoi me fitues si dhe për shkak të një rregullimi ligjor jo të plotë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me shkresën me nr. 451 prot., dat 26.05.2021, me lëndë: “Informacion mbi ecurinë e vlerësimit të aplikimeve për financim dhe të shqyrtimit të ankesave nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”; si dhe me shkresën me nr. 549 prot., datë 23.06.2021, me lëndë: “Mbi mundësitë për përmirësimin e procedurës së thirrjes dhe vlerësimit të aplikimeve për financim” i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë duke propozuar:

- Ngritjen e një grupi pune ad hoc në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, për të draftuar një metodologji vlerësimi që t'i vijë në ndihmë anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit në procedurat pasardhëse.

Gjithashtu, kërkesa për kontribut në kuadër të përmirësimit të procedurës së vlerësimit të projekteve propozimeve për financim i është përcjellë dhe 12 (dymbëdhjetë) organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë me shkresën me nr. 549 prot., datë 23.06.2021. Nuk rezulton të jetë përcjellë asnjë kontribut nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara.

¹ Deri më tani nuk është iniciuar asnjë proces gjyqësor kundër Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas/Ministrisë së Drejtësisë lidhur me refuzimin e kërkesave për financim.

Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 2823/3 prot., datë 19.07.2021, bëhemi me dije se: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, si organi kompetent i fushës duhet të ndërmarrë iniciativën propozuese që të vijojë me përgatitjen e metodologjisë me burimet njerëzore të vetë institucionit.

Në këtë kuadër, me qëllim realizimin e një procedure të suksesshme financimi, si një detyrim ligjor i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, përcaktuar në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ndërmorri masat për hartimin e një draft metodologjie mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Kjo metodologji shërben si një udhëzues i cili ka për qëllim t’i mundësojë organizatave jofitimprurëse të autorizuara si dhe Komisionit të Vlerësimit/Komisionit të Ankimit që të zbatojnë në mënyrë të unifikuar kriteret, procedurat dhe mënyrën e vlerësimit të projekt-propozimeve të përcjella për financime nga buxheti i Shtetit.

Në përpilimin e këtij akti janë marrë për bazë:

- “Metodologjia për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile” përgatitur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian;
- Rregullorja e Ministrisë së Financave të Kosovës, nr-04/2017, “Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Ojq-Ve”;
- Aktet nënligjore të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mbi procedurat e financimit me grante në mbështetje të shoqërisë civile

Këto dokumenta marrin për bazë praktikën e mira rajonale dhe ndërkombëtare që mundësojnë zbatimin me transparencë të thirrjeve publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJF-ve përmes fondeve publike.

Kjo metodologji me shkresën nr. 911 prot., dt. 15.11.2021, i është përcjellë për Ministrinë së Drejtësisë në cilësinë e institucionit politikbërës në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti sipas përcaktimeve të nenit 7, shkronja “a” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë me shkresën me nr. 910 prot., dt. 15.11.2021.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 5950/2 Prot, datë 14.01.2022 ka mbajtur qëndrimin se versioni aktual i draft metodologjisë së financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë është në përputhje me ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe VKM nr. 110/2019.

Pas dhënies së konfirmimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, me urdhrin nr. 5 datë 18.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm u miratua Metodologjia mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara.

Në përputhje me pikën 4 të VKM 110/2019, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas do të bëjë publike planin vjetor të financimit si dhe thirrjen drejtuar organizatave brenda një muaji nga miratimi i buxhetit.

2.4 Të dhënat statistikore për vitin 2021, ndihma juridike parësore

32 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në mbi 95 % të territorit të vendit


- ✓ **10 (dhjetë)** qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë; Durrës; Shkodër ; Lezhë; Lushnjë; Pogradec; Gjirokastrë; Vlorë; Fier dhe Dibër;
- ✓ **12 (dymbëdhjetë) organizata** jofitimprurëse të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër, të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë
- ✓ **11 (njëmbëdhjetë Marrëveshje Bashkëpunimi me Klinikat Ligjore** pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Vlorë dhe Shkodër.
- ✓ Ndhma Juridike Parësore ONLINE (platformajuristonline.al) dhe ndihma juridike në E-Albana.
- ✓ Numri i gjelbër pa pagesë 08001010

Viti 2021						
Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Organizatat Jofitimprurëse të autorizuar	Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	Platforma Juristonline	Numri i gjelbër 08001010	Totali i rasteve të raportuara
Janar	169	205	3	178	76	631
Shkurt	216	179	10	213	61	679
Mars	209	228	4	219	81	741
Prill	273	237	6	138	57	711
Maj	255	220	2	147	65	689
Qershor	307	180	2	120	50	659
Korrik	255	374	0	171	34	834
Gusht	201	75	0	172	37	485

Shtator	321	183	6	178	42	730
Tetor	370	172	4	139	30	715
Nëntor	373	185	24	103	47	732
Dhjetor	236	160	0	126	25	547
Total	3185	2398	61	1904	605	8153

- **Natyra e çështetjeve të ndihmës juridike parësore për vitin 2021:**


Civile	4327
Penale	744
Administrative	2931
Total	8002



Shënim: Nuk janë përfshirë të dhënat e numrit të gjelbër nisur fakti se natyra e ofrimit të këtij shërbimi nuk kërkon domosdoshmërisht kategorizimin e qytetarëve.

- **Kategoritë përfituese të ndihmës juridike parësore për vitin 2021:**


Te ardhura dhe pasuri te pamjaftueshme	3084
Kategori e Vecante	1681
Papercaktuar	879
Total	5644



Shënim: Nuk janë përfshirë të dhënat e platformës juristionline dhe numrit të gjelbër nisur fakti se natyra e ofrimit të këtij shërbimi nuk kërkon domosdoshmërisht kategorizimin e qytetarëve.


- Gjinia e përfituesve të ndihmës juridike parësore për vitin 2021

Femra	3263
Meshkuj	2381
Total	5644




Shënim: Nuk janë përfshirë të dhënat e platformës juristionline dhe numrit të gjelbër nisur fakti se natyra e ofrimit të këtij shërbimi nuk kërkon domosdoshmërisht kategorizimin e qytetarëve sipas gjinisë.

TOTALI I RASTEVE TË RAPORTUARA NGA OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE 2021



TOTAL NDIHMA JURIDIKE PARËSORE 2019-2021 (12.367 Raste)



3. Ndhimja juridike dytësore

Ndhimja juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Me ndryshimet e reja të kuadrit ligjor për ndihmën juridike, përveç përfaqësimit me avokat falas, tashmë qytetarët në nevojë dhe kategoritë vulnerabël kanë mundësi të përfitojnë edhe nga forma e shtuar e shërbimit ligjor falas, atë të përjashtimit nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Nisur dhe nga natyra e çështjeve të ndihmës juridike, karakteri sensitiv që ato kanë, përfaqësimi me avokat falas dhe ndjekja e procesit në gjykatë është i një rëndësie thelbësore për rivendosjen në vend të të drejtave për kërkuesit e shërbimit.

Ndhimja juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit Nr.111/2017.

3.1 Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 111/2017, gërma k), DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Në muajin Janar, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative për vitin 2021.

Gjatë kësaj procedure u respektua Parimi i Rotacionit si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët Nr.17, datë 05.08.2020, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke garantuar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga DHASH, DNJF vijoi me procesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për vitin 2021.

Lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike falas u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë² dhe për vitin 2021 janë lidhur kontrata për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore me **124 avokatë**. Në vijim, përgjatë vitit , **pesë** nga avokatët kanë kërkuar të mos jetë më pjesë e listës.

² <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/publikime/>

3.2 Trajnimi i avokatëve pjesë e listës

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve; ndërveprimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Dhomat Vendore të Avokatisë si dhe të shkëmbimit të konsideratave, u zhvillua trajnimi i dedikuar për ndihmën juridike dytësore.

Ky trajnim u zhvillua si rezultat si një bashkëpunimi ndërmjet UNDP, ADA, DhAsh, MD dhe FLAD. Trajnimi u konsultua në 2 sessione gjatë të cilave janë diskutuar tema specifike të ndërlidhura me ofrimin e shërbimit, parë kjo dhe nga këndvështrimi i praktikës.

Sessioni i parë i trajnimit u zhvillua më datat **15-16 Prill 2021**. Gjatë këtij sessioni trajnimi ofruesit e ndihmës juridike dytësore janë trajnuar specifikisht mbi:


- Legjislacioni mbi ndihmën juridike dhe rëndësia e tij edhe në nivel ndërkombëtar;
- Ligji për ndihmën juridike dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij;
- Format e shërbimit të ndihmës juridike dhe subjektet përfitues të shërbimit;
- Analizë në aspektin praktik;
- Standardet e ofrimit të shërbimit në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së;
- Diskutime praktike ndërmjet ofruesve të shërbimit, Dhomave të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.
-

Sessioni i dytë i trajnimit u zhvillua më datat **22 dhe 22 Prill 2021**. Pas diskutimeve të temave mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, aspektet e dala nga zbatimi në praktikë i ligjit, sessioni I dytë i trajnimit ju dedikua temave të posaçme të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese të ligjit. Janë diskutuar në terma konkretë.

3.3 Ecuria e vendime për pranimin e ndihmës dytësore


Nga vendimet gjyqësore me objekt kërkesën për ndihmë juridike dytësore falas, të administruara nga DNJF për Vitin 2021, në total rezultojnë **849** vendime gjyqësore. Këto vendime mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore të detajuara në formë tabelare janë si vijon:

Vendime Gjyqësore me Objekt Kërkesën për Ndihmë Juridike Dytësore						
JANAR – DHJETOR 2021						
Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore	Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore	Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Kthim aktesh/pushim cështjeje/cështje në gjykim/moskompetencë/
315	41	113	3	356	14	7
Totali i Vendimeve Gjyqësore për Kërkesat për Ndihmë Juridike Dytësore = 849						




Në ecurinë përgjatë muajve, mesatarja aritmetike e kërkesave të pranura për ndihmë dytësore juridike është përafërisht **58** kërkesa për secilin muaj. Muaji me numrin më lartë të kërkesave të pranura ishte muaji **Tetor** me **112** vendime dhe numri me numrin më të ulët të kërkesave të pranura ishte muaji **Janar** me **21** vendime.

**Kërkuesit e ndihmës juridike
dytësore sipas vendime
gjyqësore për vitin 2021**




**Gjinia e kërkuesve të ndihmës
sipas vendime gjyqësore për
vitin 2021**



Përsa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se 70% e tyre pretendojnë pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie. Ndërsa në pjesën prej 30% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si personat viktimë të dhunës, përfitues të skemave sociale, e të tjerë. Ndërsa përsa i përket gjinisë, 65% e kërkuesve rezultojnë gra dhe 35% rezultojnë burra.

**Vendimet e gjykatave për kërkesat për ndihmë juridike të
garantuar sipas objektit për vitin 2021**




Sipas objektit të çështjeve gjyqësore që qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike dytësore, evidentohet që kryesisht që janë ccështje të karakterit civil. Nga totali i kërkesave për ndihmë juridike prej 849, prej tyre 754 janë civile, ku më kryesoret janë zgjidhje martese, përfitim pensioni dhe konflikte pronësie. Ndërsa dy kategoritë e tjera kanë një peshë të barabartë, ku **61** janë penale dhe **57** janë ccështje administrative.

Përsa i përket pranimi të kërkesave të qytetarëve nga vendimet e gjykatave, evidentohet një marzh shumë i ulët i refuzimit. Nga totali i kërkesave, në **41** vendime gjykatat janë shprehur për refuzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore falas, thënë ndryshe në **5%** të totalit.

Referuar detyrimeve dhe tagrave ligjore, Drejtoria Ndhmës juridike Falas përsa i përket vendimeve për pranim të dhëna nga gjykatat, ka kryer ankime dhe ankesa për ndreqje gabimesh. Përsa i përket ankimeve, DNJF ka ankimuar ose ka bërë kërkesë për ndreqje gabimi për rreth **15%** të totalit. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave kanë ardhur për mangësi formale në vendimmarrjen e gjykatave, por gjithashtu një pjesë të konsiderueshme zënë raste ku DNJF ka pretenduar një vendimmarrje jo të saktë nga gjykatat.

Përsa i përket llojit të ndihmës juridike dytësore falas të kërkuar, nga 849 vendime në total, **315** prej tyre janë për kërkesa për të përfituar avokat, **113** për të përfituar mbulim të shpenzimeve gjyqësore dhe **356** janë kërkesa për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore.



3.4 Caktimi i Avokatëve

Nëse analizojmë tërë vendimmarrjen e gjykatave, të përshkruar më sipër, konkretisht, rezulton se Dhomat Vendore të Avokatisë do të duhej të kishin komunikuar vendimmarrjen për caktim të **630 avokatëve**. Ky numër rezulton nga shumtorja e kërkesave për të përfituar avokat, dhe kërkesave për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore. Prej këtij totali, zbritet numri i vendimeve të marra për refuzim të kërkesës nga gjykatat³.

Nga analiza e të dhënave rezulton se, për Dhomën Vendore të Avokatisë Lezhë ka qenë numri më i lartë i vendimeve për caktimin e avokatëve për **68** raste. Ajo ndiqet nga Dhoma Vendore Tiranë për **45** raste, dhe Dhoma Vendore Durrës për **42** raste. Në total rezulton se nga Dhomat Vendore janë dhënë **198** vendime për caktim avokatësh, të cilat i janë komunikuar DNJF përgjatë vitit 2021.

Sipas këtyre shifrave, rezulton se për rreth **2/3 të vendimeve gjyqësore** që kanë pranuar kërkesën e qytetarëve për avokatë, Dhomat Vendore të Avokatisë nuk kanë komunikuar vendimin e caktimit të avokatit. Në këto rrethana, ndër të tjera, bëhet e pumundur vlerësimi nëse Dhomat kanë respektuar parimin e rotacionit në vendimmarrjen e tyre.

Jan	Shk	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Sht	Tet	Nënt	Dhjet	Tot
Dhoma e Avokatisë Shkodër												
0	1	9	0	2	1	4	0	0	0	0	1	18
Dhoma e Avokatisë Lezhë												
4	68	4	6	5	12	6	2	9	11	9	0	68
Dhoma e Avokatisë Durrës												
3	5	8	0	2	5	13	1	4	7	0	4	42
Dhoma e Avokatisë Tiranë												
0	11	6	4	8	4	3	1	3	3	0	2	45
Dhoma e Avokatisë Elbasan												
1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Dhoma e Avokatisë Sarandë												
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhoma e Avokatisë Vlorë												
0	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	2
Dhoma e Avokatisë Gjirokastrë												
1	4	1	6	1	0	0	0	0	0	0	0	13
Dhoma e Avokatisë Berat												
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhoma e Avokatisë Kukës												
0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Dhoma e Avokatisë Fier												
0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Dhoma e Avokatisë Vlorë												
0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Dhoma e Avokatisë Pogradec												
0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1

³ Nga ky numër duhet të zbritet, në rastin nëse gjykatat do të pranojnë ankimet e depozituara nga DNJF.

Dhoma e Avokatisë Korçë													
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhoma e Avokatisë Lushnje													
2	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	3
Dhoma e Avokatisë Dibër													
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
198 vendime për caktim avokati të përcjellë DNJF													

Në konkluzion të të dhënave statistikore dhe në qasje krahasuese:

I. Nga analiza e të dhënave, në krahasim me ecurinë gjatë vitit 2019 dhe 2020, konstatohet një rritje progresive me shumëfishim të kërkesave për ndihmë juridike dytësore. Më konkretisht, për vitin 2019, janë marrë **32** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar. Ndërsa, për vitin 2020, janë marrë **181** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar.

II. Përsa i përket raportit të natyrës së çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar ndihmë, në analizë disa vjeçare shihet ruajtja e plotë e raportit. Më konkretisht ccështjet civile shkojnë deri më pak se 90% të totalit të ccështjeve për të cilat kërkohet ndihmë. Më konkretisht, në vitin 2019, nga **32** vendime, **28** ishin për çështje civile, **4** penale dhe **1** administrative. Ndërsa për vitin 2020, nga **181** vendime, **154** ishin për çështje civile, **13** penale dhe **14** administrative.

III. Përsa i përket natyrës së ndihmës dytësore falas të kërkuar nga qytetarët, në raportin ndër vitë shihet një raport kostant. Në rreth **20%** të totalit të kërkesave kërkohet vetëm mbulim i shpenzimeve gjyqësore. Ndërsa në pjesën tjetër kërkohet avokat, sëbashku ose jo edhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore.

Problematika lidhur me ndihmën juridike dytësore:

- Vendimet e gjykatës vijnë pa firmë dhe vulë sipas parashikimeve në K.Pr. Civile;
- Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe rretheve vijnë deri më 6 muaj vonesë në protokollin e DNJF-së, duke sjellë pasoja për qytetarët;
- Vendimet e gjykatës përvec mungesës së ekstremiteteve, nuk japin as adresën e saktë të banimit ose celularin e subjektit që përfiton ndihmë juridike dytësore;
- Avokatët kalojnë afatin 3 mujor për ngitjen e padisë në gjykatat e juridiksionit;
- Mungesa e informacionit nga momenti i ngritjes së padisë deri në cdo fazë të gjykimit, civil, penal, administrativ nga avokatët dhe dhomat e avokatisë në Tiranë dhe rrethe.

4. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore dhe dytësore

4.1 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore (Janar-Dhjetor 2021)

Referuar Ligjit nr. 111/2017, *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas: Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Për të përmbushur qëllimet e përfunduara në ligj, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndihmës Juridike është drejtoria e krijuar brenda Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas që ka përgjegjësinë e kryerjes së monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme në funksion të vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; mirorganizimi, miradministrimi dhe mirëfunksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike si dhe garantimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efikente dhe efektive janë disa nga qëllimet kryesore të Ligjit nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.

Këto qëllime shërbejnë si udhëzues të mënyrës si kryhet monitorimi i cilësisë së shërbimit, procesi i cili detajohet në Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*.

Në përmbushje të shkronjës “l” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”* ku përcaktohet se: *“Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore”*, DNJF ka hartuar kalendarin e mbikëqyrjes për vitin 2021, në të cilin ka detajuar të gjitha monitorimet që do të kryhen përgjatë këtij viti.

Lidhur me monitorimin e avokatëve të ndihmës juridike, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndihmës Juridike ka vijuar me kryerjen e monitorimeve e të gjitha Qendrave dhe monitorimin fillestar të avokatë ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

4.2 Analizë e raporteve të monitorimit

Referuar parashikimeve të metodologjisë së miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga qendrat bazohet në monitorimet tre-mujore të kryera si dhe raportet mujore narrative të përcjella nga ana e punonjësve të Qendrave. Për çdo raport mujor të përcjellë analizohen të dhënat si dhe orientimi ligjor / zgjidhja e rasteve të trajtuara. Gjithashtu, raportet synojnë të adresojnë problematika dhe rekomandime nga ana e punonjësve të qendrave në funksion të përmirësimit të ecurisë së veprimtarisë dhe ofrimit të shërbimit nga ana e tyre.

Nga monitorimet e kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, **ka rezultuar** se:

- *Lidhur me mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr.111/2017: Pjesa më e madhe e Qendrave administrojnë dokumentacionin që kërkohet për të përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore (formularët e aplikimit; dokumentat vërtetues për kushtet e pamundësisë / kategoritë e veçanta; skeda e klientit; procesverbali etj), por jo të gjitha Qendrat administrojnë dokumentacion për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. (dokumentacionin provues - shkresor ose në cdo formë tjetër të kërkuar nga ligji).*

- *Pritja dhe trajtimi i qytetarëve, përfitues të shërbimit: Pritja dhe trajtimi i klientëve duhet të formalizohet përmes një protokolli të mirëfilltë, sipas parashikimeve në Urdhrin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë (ky protokoll mund të punohet duke bashkëpunuar edhe me punonjësit e Qendrave të tjera që administrohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas). Rezulton se pjesa më e madhe e Qendrave nuk e kanë këtë dokument.*

Konkluzione:

1. Përcjellja e raporteve mujore narrative

Lidhur me përcjelljen e Raporteve Mujore Narrative nga ana e Qendrave të shërbimit të ndihmës Juridike parësore, rezulton se jo të gjitha qendrat i përcjellin për çdo muaj respektiv (raporti është për qendrën dhe jo për punonjës). Vihet re një mungesë bashkëpunimi në këtë kuadër.

2. Punonjësit e qendrave nuk përcjellin problematika / rekomandime

Në raportet mujore rezulton se në pjesën më të madhe të tyre nuk plotësohet rubrika në të cilën pasqyrohen problematika / vështirësi që qendrat hasin në terren dhe rekomandime nga ana e punonjësve. Plotësimi i kësaj rubrike është shumë i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit efektiv dhe marrjes së masave nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike për zgjidhjen e problematikave që përcillen.

3. Numri i ulët i rasteve

Nga raportet e dërguara nga ana e qendrave si dhe nga të dhënat statistikore të përpunuara nga Drejtoria e Politikave sa i përket qendrave parësore, rezulton se nga disa qendra janë trajtuar një numër shumë i ulët rastesh.

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- **Në fokus:** rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

4.3 Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave

Monitorimet u ushtruan duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë, dhe efektivitetit.

Kalendari i monitorimeve të kryera për vitin 2021				
Monitorimi i parë i Qendrave				
	Qendra e Shërbimit	Monitorimi Nr. 1	Monitorimi Nr. 2	Monitorimi Nr. 3
1	Qendra Durrës	16.03.2021	02.09.2021	17.12.2021
2	Qendra Lezhë	24.03.2021	02.09.2021	20.12.2021
3	Qendra Lushnje	27.04.2021	23.11.2021	--
4	Qendra Shkodër	27.04.2021	02.09.2021	06.01.2022
5	Qendra Tiranë	28.04.2021	21.12.2021	---
6	Qendra Pogradec	11.05.2021	02.09.2021	01.12.2021
7	Qendra Fier	15-16.06.2021	02.09.2021	21.12.2021
8	Qendra Vlorë	15-16.06.2021	02.09.2021	21.12.2021
9	Qendra Gjirokastrë	27.04.2021	10.09.2021	21.12.2021
10	Qendra Dibër	02.09.2021	--	--

Në vijim paraqitet një përmbledhje e monitorimeve të zhvilluara respektivisht në secilën nga Qendrat dhe gjetjet/rekomadimet përkatëse:

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë

Në zbatim të Urdhërit Nr. 173, datë 21.12.2021 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Shërbimit të Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Tiranë”, është realizuar mbikëqyrja, për të cilën ju informoj si mëposhtë:

Më datë **24.12.2021** është kryer kontrolli në Qendrën e Shërbimeve të Ndhmës Parësore Tiranë me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe përshtatshmërinë e ambjenteve pritëse sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “*Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike*”.

Janë kërkuar për verifikimin dosjet e të gjithë qytetarëve që janë trajtuar nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë dhe janë tërhequr për qëllime dokumentimi shkresat e hartuara nga punonjësit për ndjekjen e problematikave të paraqitura.

Në përfundim, lutem gjeni **Komente dhe Rekomandime të Mbikëqyrësit:**

1. Janë mbajtur dosje për çdo rast të trajtuar, për çdo muaj (për qytetarët që kanë përfituar ndihmë juridike parësore).
Është mbajtur pjesërisht dokumentacioni provues mbi ndjekjen e problematikës së parashtruar, për rastet kur është proceduar me shkresë drejtuar institucioneve shtetërore, dhe dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.
Rekomandim: Të mbahet për çdo rast të trajtuar për këshillim ligjor dokumentacioni provues (shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji) për zgjidhjen e rastit.
2. Nga monitorimi i kryer rezulton se nuk janë përmbushur rekomandimet lidhur me:
 - Mbajtjen e procesverbalit sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
 - Protokoll i formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Nga monitorimet e kryera gjatë viti 2021 vërehet se ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndhmja Juridike Parësore nga Qendra përveç se shërbimeve të mësipërme, ka evidentuar dhe dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme drejtuar organeve shtetërore, por ky shërbim duhet të vijojë përfshirë

dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, deri në zgjidhjen e rasteve të paraqitura nga qytetarët pranë QNJP.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnje

Në zbatim të Urdhërit Nr. 161, datë 23.11.2021 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofritit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnje”*, u urdhërua kryerja e kontrollit pranë Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Lushnje, me objekt kryerjen e monitorimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, me qëllim verifikimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit miratuar me Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofritit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*.

Kontrolli nga nënpunësi mbikëqyrës u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofritit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*.

Ky kontroll u ushtrua duke pasur në fokus, mënyrën e ofritit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofritit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë dhe efektivitetit.

Nga monitorimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me qendrën ka rezultuar se:

- Janë mbajtur dosje të ndara për çdo rast të trajtuar (për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore).
- Në dosjet e trajtuara është mbajtur proces-verbali sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.
- Janë administruar provat që vërtetojnë pamjaftueshmërinë ekonomike të subjekteve përfituese.
- Në shumë raste krahas formularëve të ofritit të ndihmës juridike dytësore është hartuar nga punonjësi i qendrës kërkesë në format ëord e argumentuar drejtuar gjykatës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.
- Nuk është plotësuar skeda e klientit, detyrim që rrjedh nga metodologjia e miratuar në këtë kuadër (Aneks 1 - miratuar me Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofritit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*).

Rekomandime:

- Për çdo rast të trajtuar Qendra duhet të administrojë skedën e klientit sipas detyrim që rrjedh nga metodologjia e miratuar në këtë kuadër (Aneks 1 - miratuar me Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”).
- Pritja dhe trajtimi i klientëve duhet të formalizohet përmes një protokolli të mirëfilltë, sipas parashikimeve në Urdhër të miratuar nga Ministri i Drejtësisë (*ky protokoll mund të punohet duke bashkëpunuar edhe me punonjësit e Qendrave të tjera që administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas*).
- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete, si dhe argumentim ligjor i zgjidhjes së ofruar duke referuar edhe dispozitat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi sipas rastit.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- Në fokus: rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet hartimi dhe përpilimi i shkresave drejtuar organeve të administratës shtetërore në rastet kur konstatohet e nevojshme nga punonjësi i qendrës.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës

Monitorimi nr. 1

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Pergjithshëm nr. 95, datë 02.09.2021, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës”, nëpunësi i caktuar nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, me datë **09.09.2021**, ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Durrës.

Nga monitorimi i kryer pranë Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Durrës, ka rezultuar se Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Durrës ka përmbushur pjesërisht rekomandimet e lëna nga grupi i mbikëqyrjes në monitorimin e mëparshëm, në drejtimit e mëposhtme:

- **Është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore** (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”);
- **Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore**, sikurse është e përcaktuar në ligj. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore);
- Është mbajtur dhe administrohet **dokumentacioni provues** që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e

punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas);

- **Janë mbajtur dosje të ndara për çdo rast** të trajtuar (për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore);
- Është mbajtur dhe administrohet **proces-verbali** sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Nga monitorimi i kryer rezultoi se **Qendra ka ndjekur një praktikë në raport me Gjykatat** dhe rastet për ndihmë juridike dytësore në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional. Punonjësit e qendrës, për çdo rast që ka patur nevojë për ndihmë juridike dytësore dhe zgjidhje gjyqësore përveç se kanë plotësuar formularët për ndihmë juridike dytësore dhe kanë përgatitur dosjen e kërkuesit, kanë përgatitur gjithashtu një kërkesë në të cilën përmbledhin rastin konkret, dokumentacionin e paraqitur dhe bazën ligjore, me qëllim lehtësimin e punës dhe adresimin sa më të detajuar të çështjes.
- Qendra **nuk ka një protokoll të formalizuar** për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Rekomandime:

- **Të mbahet protokoll i mirëfilltë** për pritjen dhe trajtimin e klientëve.
- **Të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna pas çdo monitorimi të kryer.** Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet që Drejtoria e Mbikëqyrjes përcjell përmes raporteve të monitorimit apo komunikimeve të vazhdueshme.
- **Fokus i veçantë - rritja e numrit të rasteve të trajtuara dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve.** Në fokus të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të jetë ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe kushtet e përfitimit. Ndërgjegjësimi ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e numrit të rasteve të trajtuara.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhërit Nr. 169, datë 16.12.2021 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Shërbimit të Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Durrës”, më datë **17.12.2021** është kryer kontrolli në Qendrën e Shërbimeve të Ndhmës Parësore Durrës.

Kontrolli u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe përshtatshmërinë e ambjenteve pritëse sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Janë kërkuar për verifikimin dosjet e të gjithë qytetarëve për muajin **Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor** që janë trajtuar nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës dhe janë tërhequr për qëllime dokumentimi shkresat e hartuara nga punonjësit për ndjekjen e problematikave të paraqitura.

Komente dhe Rekomandime të Mbikëqyrësit:

1. Janë mbajtur dosje për çdo rast të trajtuar, për çdo muaj (për qytetarët që kanë përfituar ndihmë juridike parësore).

Është mbajtur dokumentacioni provues mbi ndjekjen e problematikës së parashtruar, për disa raste kur është proceduar me shkresë drejtuar institucioneve shtetërore, por në dosjet e trajtuara mungon dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.

Rekomandim: Për çdo rast të trajtuar të mbahet dokumentacioni provues (*shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji*) për zgjidhjen e rastit.

2. Rezulton se nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Rekomandim: Të mbahet protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klientëve.

Nga monitorimet e kryera gjatë viti 2021 vërehet se ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndihma Juridike Parësore nga Qendra përveç se shërbimeve të mësipërme, duhet të evidentohet dhe me dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, si dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, me qëllim jo vetëm identifikimin e problematikës por dhe zgjidhjen e rastit të paraqitur nga qytetari pranë QNJ.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër

Monitorimi nr. 1

Në zbatim të Urdhrit Nr. 103, datë 02.09.2021, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin Cilësisë së Shërbimit të Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Shkodër”, nëpunësi i caktuar me datë **08.09.2021** ka ushtruar kontroll të cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Shkodër.

Kontrolli nga mbikëqyrësi u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhrin nr.531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Drejtorja e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike në kuadër të vlerësimit të cilësisë të shërbimit të ndihmës juridike parësore, ka analizuar me kujdes veprimtarinë e kryer nga punonjësit e qendrës sipas të gjithë indikatorëve të përcaktuar në dokumentin e metodologjisë së miratuar për këtë qëllim dhe ka vijuar me gjetjet dhe konstatimet si vijon:

- **Është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore** (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”);
- **Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore**, sikurse është e përcaktuar në ligj. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore);
- Është mbajtur dhe administrohet **dokumentacioni provues** që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas);
- **Janë mbajtur dosje të ndara për çdo rast** të trajtuar (për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore);
- Është mbajtur dhe administrohet **proces-verbali** sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Qendra **nuk ka një protokoll të formalizuar** për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Rekomandime:

- **Të mbahet protokoll i mirëfilltë** për pritjen dhe trajtimin e klientëve.
- **Të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna pas çdo monitorimi të kryer.** (Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet që Drejtoria e Mbikëqyrjes përcjell përmes raporteve të monitorimit apo komunikimeve të vazhdueshme.)
- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore;
- **Në fokus:** rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhërit Nr. 103, datë 02.09.2021 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Shërbimit të Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Durrës”, më datë **6. 01. 2022** është kryer kontrolli në Qendrën e Shërbimeve të Ndhmës Parësore Shkodër.

Kontrolli u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe përshtatshmërinë e ambienteve pritëse sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të

shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Janë kërkuar për verifikimin dosjet e të gjithë qytetarëve për muajin **Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor** që janë trajtuar nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër dhe janë tërhequr për qëllime dokumentimi shkresat e hartuara nga punonjësit për ndjekjen e problematikave të paraqitura.

Komente dhe Rekomandime të Mbikëqyrësit:

3. Janë mbajtur dosje për çdo rast të trajtuar, për çdo muaj (për qytetarët që kanë përfituar ndihmë juridike parësore).

Është mbajtur dokumentacioni provues mbi ndjekjen e problematikës së parashtruar, për disa raste kur është proceduar me shkresë drejtuar institucioneve shtetërore, por në dosjet e trajtuara mungon dokumentacioni provues që kërkuar i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.

Rekomandim: Për çdo rast të trajtuar të mbahet dokumentacioni provues (*shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji*) për zgjidhjen e rastit.

4. Rezulton se nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Rekomandim: Të mbahet protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klientëve.

Nga monitorimet e kryera gjatë viti 2021 vërehet se ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndhma Juridike Parësore nga Qendra përveç se shërbimeve të mësipërme, duhet të evidentohet dhe me dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, si dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, me qëllim jo vetëm identifikimin e problematikës por dhe zgjidhjen e rastit të paraqitur nga qytetari pranë QNJ.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë

Monitorimi nr. 1

Në mbështetje të Urdhrit Nr. 107, datë **02.09.2021**, të Drejtorit të Përgjithshëm “*Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë*”, nëpunësi i caktuar ka ushtruar kontroll të cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, me objekt kryerjen e monitorimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, me qëllim verifikimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit miratuar me Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “*Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike*”.

Kontrolli nga nënpunësi mbikëqyrës u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhrin nr.531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike në kuadër të vlerësimit të cilësisë të shërbimit të ndihmës juridike parësore, ka analizuar me kujdes veprimtarinë e kryer nga punonjësit e qendrës sipas të gjithë indikatorëve të përcaktuar në dokumentin e metodologjisë së miratuar për këtë qëllim dhe ka vijuar me gjetjet, konstatimet, si vijon:

Rezulton se janë përmbushur rekomandimet lidhur me:

- **Mbajtjen e skedës së klientit të ndihmës juridike parësore**, aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës;
- **Protokoll i formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.**

Rekomandohet:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete;
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhërit Nr. 175, datë **21.12.2021** “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë”, u urdhërua kryerja e kontrollit pranë Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, me objekt kryerjen e monitorimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, me qëllim verifikimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit miratuar me Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Kontrolli u ushtrua duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë dhe efektivitetit. Janë raportuar 93 raste të trajtuara nga qendra, për muajt Shtator, Tetor, Nëntor.

- Në disa nga rastet e raportuara nga qendra **mungon dokumentacioni provues** që kërkuesit është subjekt përfitues si dhe konkretisht shkresa të ASHK-së, Drejtorisë së Transportit Rrugor etj.
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore
- Është mbajtur skeda e klientit për çdo rast si dhe procesverbalët përkatës
- Nnë raste të gjykimit të nevojës për hartimin e shkresave drejtuar. Organeve të administratës publike, janë hartuar nga punonjësit e qendrës shkresa të tilla.

Bazuar në problematikat e konstatuara më sipër mungesën pjesërisht të dokumentacionit provues që kërkuesit është subjekt përfitues ligjit, sipas kriterëve të ligjit u rekomandua si më poshtë:

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore nëpërmjet organizimit të aktiviteteve ndërgjegjëse.
- Për çdo rast të trajtuar të administrohet **dokumentacioni i plotë provues** (shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji) përpara dërgimit të formularit për përfitim nga ndihma juridike dytësore gjykatës. Në rast të mosadministrimit të provave pa fajin e punonjësit të qendrës të hartohet një raport/shkresë përcjellëse drejtuar gjykatës bashkëlidhur formularit ku të spjegohen rrethanat dhe të spjegohet mosadministrimi pa faj i dokumentacionit nga qendra/ kërkuesi si dhe të kërkohet marrja e detyruar e provave që lidhen me pamjaftueshmërinë ekonomike edhe nga organet e administratës publike që kanë refuzuar dhënien e provave shkresore.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë

Monitorimi nr. 1

Në zbatim të Urdhrit nr. 103, datë 02.09.2021, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë”, nëpunësi i caktuar nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, me datë **07.09.2021** ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Lezhë.

Nga monitorimi i kryer pranë Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Lezhë ka rezultuar se Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Lezhë ka përmbushur pjesërisht rekomandimet e lëna nga grupi i mbikëqyrjes në monitorimin e mëparshëm, në drejtimit e mëposhtme:

- **Nuk është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore** (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofritit të shërbimeve të ndihmës

juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”);

- **Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore**, sikurse është e përcaktuar në ligj. *(nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore);*
- Është mbajtur dhe administrohet **dokumentacioni provues** që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. *(nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas);*
- **Janë mbajtur dosje të ndara për çdo rast** të trajtuar *(për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore);*
- **Nuk është mbajtur dhe nuk administrohet proces-verbali** sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Qendra **nuk ka një protokoll të formalizuar** për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Rekomandime:

- Për çdo rast të paraqitur pranë qendrës të plotësohet Aneksi 1- Skeda e klientit të ndihmës juridike parësore.
- Për cdo rast të trajtuar gjatë ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore të mbahet proces-verbali sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- *Të mbahet protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klientëve;*
- *Të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna*
- *pas çdo monitorimi të kryer.*
- *(Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet që Drejtoria e Mbikëqyrjes përcjell përmes raporteve të monitorimit apo komunikimeve të vazhdueshme.)*
- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete;
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- **Në fokus:** rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhrit Nr. 170, datë 16.12.2021 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Shërbimit të Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Lezhë”, më datë **20.12.2021** është kryer kontrolli në Qendrën e Shërbimeve të Ndhmës Parësore Lezhë, me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës,

rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe përshtatshmërinë e ambjenteve pritëse sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*.

Janë kërkuar për verifikimin dosjet e të gjithë qytetarëve për muajin **Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor** që janë trajtuar nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë. Ka rezultuar se, nga punonjësit e qendrës nuk janë hartuar shkresa për ndjekjen e problematikave, për asnjë nga rastet e paraqitura. *Janë raportuar 135 raste të trajtuara nga qendra, për muajt Shtator, Tetor, Nëntor, deri më 20 Dhjetor.*

Komente dhe Rekomandime të Mbikëqyrësit:

1. Janë mbajtur dosje për çdo rast të trajtuar, për çdo muaj (për qytetarët që kanë përfituar ndihmë juridike parësore).
2. Në dosjet e trajtuara mungon dokumentacioni provues mbi ndjekjen dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga qytetari.
3. Nuk është proceduar me shkresë drejtuar institucioneve shtetërore, për asnjë nga rastet e paraqitura pranë qendrës.
4. **Rekomandim:** Për çdo rast të trajtuar të mbahet dokumentacioni provues (shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji) për zgjidhjen e rastit.
5. Rezulton se nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.
6. **Rekomandim:** Të mbahet protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klientëve.

Nga monitorimet e kryera gjatë vitit 2021 vërehet se ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndihma Juridike Parësore nga Qendra përveç se shërbimeve të mësipërme, duhet të evidentohet dhe me dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, si dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, me qëllim jo vetëm identifikimin e problematikës por dhe zgjidhjen e rastit të paraqitur nga qytetari pranë QNJ.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec

Monitorimi nr. 1

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 101, datë 02.09.2021 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec”*, grupi i punës nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, me datë **20.09.2021** ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Pogradec.

Nga monitorimi i kryer pranë Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Pogradec ka rezultuar se:

- **Është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore** (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”);
- **Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore**, sikurse është e përcaktuar në ligj. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore);
- Është mbajtur dhe administrohet **dokumentacioni provues** që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas);
- **Janë mbajtur dosje të ndara për çdo rast** të trajtuar (për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore);
- Është mbajtur dhe administrohet **proces-verbali** sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Rekomandime:

- Të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna pas çdo monitorimi të kryer. (Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet që Drejtoria e Mbikëqyrjes përcjell përmes raporteve të monitorimit apo komunikimeve të vazhdueshme).
- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me **eficiencë të plotë** duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- **Të vijohet me promovimin** e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- **Në fokus:** rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet **bashkëpunimi edhe me qendrat e tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore** të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhrit nr. 165 prot., datë 26.11.2021, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec”, nëpunësi i mbikëqyrjes nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike, me datë **01.12.2021** ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndhmës Juridike Parësore Pogradec.

Ky kontroll u ushtrua duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë, dhe efektivitetit. *Janë raportuar 50 raste të trajtuara nga qendra, për muajt Shtator, Tetor, Nëntor.*

- Në rastet e raportuara nga qendra administrohet **dokumentacioni provues** që kërkuesit është subjekt përfitues .
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore.
- Është mbajtur skeda e klientit për çdo rast si dhe procesverbalët përkatës.

Bazuar në problematikat e konstatuara më sipër konkretisht numrit të subjekteve përfitues nga ndihma juridike parësore , u rekomandua si më poshtë

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.(edhe pse konstotahot dhënia me cilësi e shërbimit për sa i përket orientimit ligjor)
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore nëpërmjet organizimit të aktiviteteve ndërgjegjëse.(referuar numrit jo të lartë të rasteve të trajtuara).

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë

Monitorimi nr. 1

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 110, datë 10.09.2021, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë”, grupi i punës nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, me datë **14.09.2021** ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë.Nga monitorimi i kryer pranë Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë ka rezultuar se:

- **Është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore** (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”).
- **Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore**, sikurse është e përcaktuar në ligj. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore);
- Është mbajtur dhe administrohet **dokumentacioni provues** që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas);

- Është mbajtur dhe administrohet **proces-verbali** sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Qendra **ka një protokoll të formalizuar** për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.
- Qendra **ka trajtuar një numër të konsiderueshëm rastesh** në krahasim me Qendrat e tjerav. Vihet re një bashkëpunim shumë i mirë i Qendrës me institucionet në nivel lokal, fakt ky që ndikon drejtpërdrejtë në referimin dhe adresimin e rasteve dhe njohjen e Qendrës përballë të tretëve.

Rekomandime:

- Të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna pas çdo monitorimi të kryer. *(Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet që Drejtoria e Mbikëqyrjes përcjell përmes raporteve të monitorimit apo komunikimeve të vazhdueshme).*
- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- **Në fokus:** Aktivitete ndërgjegjësuere për qytetarët.

Në fokus të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të jetë ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe kushtet e përfitimit. Ndërgjegjësimi ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e numrit të rasteve të trajtuara.

- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhrit Nr. 174, datë 21.12.2021 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër”, u urdhërua kryerja e kontrollit pranë Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër, me objekt kryerjen e monitorimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, me qëllim verifikimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit miratuar me Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Ky kontroll u ushtrua duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë dhe efektivitetit.

Metodologjia e përdorur për ushtrimin e kontrollit ishte leximi i akteve të dosjeve. Janë kërkuar për verifikimin dosjet e të gjithë qytetarëve për muajt Shtator, Tetor, Nëntor që janë trajtuar nga Qendra

e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër. Janë raportuar 220 raste të trajtuara nga qendra, për muajt Shtator, Tetor, Nëntor.

- Është administruar në çdo rast **dokumentacioni provues** që kërkuesit është subjekt përfitues.
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore.
- Është mbajtur skeda e klientit për çdo rast si dhe procesverbalët përkatës.
- Nnë raste të gjykimit të nevojës për hartimin e shkresave drejtuar. Organeve të administratës publike, janë hartuar nga punonjësit e qendrës shkresa të tilla, të mirëargumentuara ligjërisht.

Në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë së qendrës në vijueshmëri, edhe pse është konstatuar cilësi në menaxhimin e rasteve nga ana e punonjësve të qendrës janë rekomanduar si më poshtë:

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore nëpërmjet organizimit të aktiviteteve ndërgjegjëse.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier

Monitorimi nr. 1

Në mbështetje të Urdhrit Nr. 107, datë **02.09.2021**, të Drejtorit të Përgjithshëm “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë”, grupi i punës nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike, ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndhmës Juridike Parësore Fier. Nga monitorimi i kryer pranë Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Fier ka rezultuar se:

- Në disa nga rastet e raportuara nga qendra **mungon dokumentacioni provues** që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.
- Mungon një protokoll i formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Bazuar në problematikat e konstatuara mësipër mungesën pjesërisht të dokumentacionit provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.

- Për çdo rast të trajtuar të mbahet **dokumentacioni** shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji për zgjidhjen e rastit.
- Të mbahet **protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klienteve**.

Monitorimi nr. 2

Në zbatim të Urdhrit Nr. 167, datë **21.12.2021** “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier”, u urdhërua kryerja e kontrollit pranë Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Fier, me objekt kryerjen e monitorimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, me qëllim verifikimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit miratuar me Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Ky kontroll u ushtrua duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë dhe efektivitetit. Metodologjia e përdorur për ushtrimin e kontrollit ishte leximi i akteve të dosjeve. Janë kërkuar për verifikimin dosjet e të gjithë qytetarëve për muajt Shtator, Tetor, Nëntor që janë trajtuar nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier. Janë raportuar 137 raste të trajtuara nga qendra, për muajt Shtator, Tetor, Nëntor.

- Në disa nga rastet e raportuara nga qendra **mungon dokumentacioni provues** që kërkuar është subjekt përfitues si dhe konkretisht shkresa të ASHK-së, Drejtorisë së Transportit Rugor etj..
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore
- Është mbajtur skeda e klientit për çdo rast
- Në raste të gjykimit të nevojës për hartimin e shkresave drejtuar Organeve të administratës publike, janë hartuar nga punonjësit e qendrës shkresa të tilla.

Bazuar në problematikat e konstatuara më sipër mungesën pjesërisht të dokumentacionit provues që kërkuar është subjekt përfitues ligjit, sipas kriterëve të ligjit u rekomandua si më poshtë

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore nëpërmjet organizimit të aktiviteteve ndërgjegjëse.
- Për çdo rast të trajtuar të administrohet **dokumentacioni i plotë provues** (shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji) përpara dërgimit të formularit për përfitim nga ndihma juridike dytësore gjykatës. Në rast të mosadministrimit të provave pa fajn e punonjësit të qendrës të hartohet një raport drejtuar gjykatës bashkëlidhur formularit ku të shpjegohen

rrethanat dhe të kërkohej marrja e detyruar e provave që lidhen me pamjaftueshmërinë ekonomike edhe nga organet e administratës publike që kanë refuzuar dhënien e provave shkresore.

Monitorim, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër

Monitorimi nr. 1

Në mbështetje të Urdhrit nr. 97, datë **02.09.2021**, të Drejtorit të Përgjithshëm “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë”, grupi i punës nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Dibër.

Kontrolli nga grupi i mbikëqyrjes u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhrin nr.531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Në përfundim, grupi i punës përgatiti raportin sipas formatit standart bashkëlidhur “Metodologjisë dhe Procedurave të Mbikëqyrjes”; Aneksi 5 “Raporti i Vlerësimit të Strukturës Organizative për Ndihmën Juridike Parësore”; Raportimet për kërkesat e trajtuara; si dhe raportin mbi mbikëqyrjen e kontrollit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore ofruar nga juristët e qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore Dibër. Nga monitorimi i kryer pranë Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Dibër ka rezultuar:

- Mungesa e skedës së klientit të ndihmes juridike parësore
- Mungesa e dokumentacionit provues për zgjidhjen e rastit;
- Nuk është ofruar ndihma juridike/asistenca për plotësimin e kërkesës së qytetarëve që kërkojnë të përfitojnë ndihmë juridike dytësore;
- Nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

5. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike

Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF është duke i kushtuar një vëmendje të shtuar zhvillimit të aktiviteteve

ndërgjegjësuese dhe edukimit ligjor të publikut duke hartuar kalendarin e aktiviteteve si dhe një plan konkret pune. Përgjatë vitit 2021, DNJF ka zhvilluar në këtë kuadër disa aktivitete që kanë në fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut jo vetëm duke u përqëndruar tek sistemi i ndihmës juridike falas por duke u ndalur edhe në informimin ligjor të publikut përmes faqes zyrtare të dedikuar të drejtorisë, rrjeteve sociale dhe videove informuese.

5.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuese

Në total, përgjatë vitit 2021, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka zhvilluar/ka marrë pjesë në rreth **125 takime/aktivitete** ndërgjegjësuese të listuara në tabelën si vijon:

Qytetet	Aktivitetet e realizuara përgjatë vitit 2021 nga DNJF dhe Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore
Tiranë	1. Aktiviteti ndërgjegjësues, datë 25.08.2021, pranë Ministrisë së Drejtësisë (informim i qytetarëve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Tiranë ; 2. Takimi i datës 26.08.2021, me përfaqësuesit e ‘Organizatës Drejtësi Sociale’, (vendosja e urave të bashkëpunimit, përpilimi i kalendarit të përbashkët të aktiviteteve) ; 3. Aktiviteti ndërgjegjësues, datë 31.08.2021, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (informim i qytetarëve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Tiranë) ; 4. Aktiviteti ndërgjegjësues, datë 01.09.2021, në bashkëpunim me Shoqatën ‘Unë Gruaja’, në qytetin e Pogradecit, (informim i qytetarëve, shpërndarje flete palosje dhe referimi i rasteve pranë qendrës Pogradec) ; 5. Takimi i datës 07.09.2021, me përfaqësues të Bashkië Tiranë dhe Koordinatorin Vendore kundër dhunës në familje, (vendosja e urave të bashkëpunimit, përpilimi i kalendarit të përbashkët me aktivitete) ; 6. Takimi i datës 17.09.2021, me Mekanizmin Koordinues të Referimit kundër Dhunës në Familje në ambjentet e qendrës Multifunksionale ‘TEN’ me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, qendrore, vendore dhe të pavarura, (vendosja e urave të bashkëpunimit, përpilimi i kalendarit të përbashkët me aktivitete) ; 7. Aktiviteti ndërgjegjësues, datë 20.09.2021, me qytetarët e komitetit Rom dhe Egjiptian, (informim i qytetarëve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Tiranë); 8. Takimi i datës 27.09.2021, me përfaqësues të Qendrës Sociale Multidisiplinare, (vendosja e urave të bashkëpunimit, përpilimi i kalendarit të përbashkët me aktivitete); 9. Aktiviteti ndërgjegjësues, datë 05.10.2021 i zhvilluar pranë ambjenteve të Qendrës Sociale Multidisiplinare, (informim grupëmohave të treta, rezidentë të qendrës, shpërndarje flete palosje dhe referimi i rasteve pranë qendrës Tiranë). 10. 22.11.2021, Paraligjorët e angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë, organizuan një aktivitet informues për qytetarët rezident në njësinë nr. 12. 11. 23.11.2021, Paraligjorët e angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë, zhvilluan një takim me përfaqësuesit e Klinikës së Ligjit pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. 12. 16.11. 2021 pranë Njesisë Administrative Dajt 13. 19.11.2021 pranë ambienteve të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u zhvillua takim me Kancelarin
Durrës	14. 28.01.2021, Aktiviteti, “Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Durrësit”, me mbështetjen e UNDP 15. 17.02.2021, Aktiviteti me temë “Së bashku në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”

	16. 12.03.2021, Takimi për rrjetëzimin e ofruesëve të shërbimeve Durrës, me temë "<i>Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve</i>" 17. 30.06.2021-01.07.2021, Organizimi i një turi vizitash pranë QSHNJPF në Durrës, Fier dhe Vlorë të një trupe gazetarësh nga televizione më zë në Shqipëri, publik dhe private me qëllim promovimin e qendrave. 18. 30.07.2021 Takimi për rrjetëzimin e ofruesëve të shërbimeve Durrës, me temë "<i>Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve</i>" 19. 06.10.2021 në bashkëpunim me QNL Takimi për rrjetëzimin e ofruesëve të shërbimeve Durrës, me temë "<i>Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve</i>" 20. 12.10.2021 Takimi për rrjetëzimin e ofruesëve të shërbimeve Durrës, me temë "<i>Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve</i>" 21. 21.10.2021 së bashku me avokatet mentoruese të QNL-së kemi shkuar në shumicën e Njësive Administrative të Bashkisë Durrës duke takuar Administratorët e Njësive, si edhe duke takuar qytetarë të ndryshëm me qëllim promovimin e Qendrës. 22. 18.11.2021 Takimi për rrjetëzimin e ofruesëve të shërbimeve Durrës, me temë "<i>Kuadri ligjor për përfitimin financiar nga Shërbimi Social I Bashkisë Durrës për viktimat e dhunës në familje dhe problematikat e hasura në praktike</i>"
Lezhe	23. 07.04.2021: Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Lezhës 24. 24.06.2021, Takim me përfaqësues të komunitetit Egjiptian, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë dhe shoqatën "<i>Shpresë për të varfërit</i>" 25. Shtator 2021: Takim informues Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë dhe Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Lezhë 26. Takim i dedikuar me përfaqësues të komuniteti rom dhe egjiptian dhe vizitë pranë vendbanimeve të tyre.
Shkodër	27. 21.01.2021, Takimi i rrjetëzimit të ofruesve të shërbimeve në Shkodër, me temë "<i>Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve</i>". 28. 25.02.2021, takimi me aktorët kyç që kontribuojnë për zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar 29. 28.04.2021, Takim në ambientet e Organizatës Shqiptare të Urdhrit të Maltës e cila është një ndër organizatat që ka në fokus të miturit. 30. 27.05.2021 në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, u zhvillua një takim i përbashkët me fokus mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave me aftësi të kufizuar, takim i cili u pasua dhe me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi. 31. 27.05.2021, në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Invalidëve të Punës u zhvillua një takim i përbashkët me fokus mbrojtjen e të drejtave ligjore të invalidëve të punës, takim i cili u pasua dhe me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi. 32. 16.06.2021, Aktivitet i përbashkët i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër me organizatën "<i>Qendra Keshillimore për Njerzit me Aftësi të kufizuar</i>" 33. 21.06.2021, Takim i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën "Gruaja te Gruaja" dhe Zyrën për "<i>Këshillimin për Djem e Burra që kryejnë veprime të dhunshme</i>" 34. 22.06.2021, Takimi i rrjetëzimit të ofruesve të shërbimeve në Shkodër, me temë "<i>Roli i Gjyqtarit në procesin civil për parandalimin e dhunës në familje</i>" 35. 23.06.2021, Takim i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën "Papa Xhovani" 36. 30.06.2021, Takim i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër me Shoqatën për Personat Tetra dhe Paraplegjik, dega Shkodër

	37. <i>Korrik 2021- Takim informues Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër dhe Shoqatën e Para Tetraplegjikëve, Dega Shkodër</i> 38. <i>9 Korrik 2021 Takim organizuar nga Fondacioni Aleanca Civile drejt Integritetit, me teme: Rehabilitimi I Viktimave të Trafikimit përmes Integritetit dhe Punesimi I tyre.!</i> 39. <i>Korrik 2021 Takim në ambjentet e Qendës Shtëpi Famiëje për të Rinja 16-18 vjec, trajtimin/diskutimin e rasteve ligjore të tyre.</i> 40. <i>Shtator 2021 Takim informues Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër</i> 41. <i>Tetor 2021, takim në ambjentet e Qendës Komunitare për Familje nr.3, për kuadrin ligjor për Kujdestarinë.</i> 42. <i>Nëntor 2021 Takim i Zhvilluar nga QNL me teme “Monitorimi dhe Vlersimi i Kuadrit Ligjor dhe Politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerzore.!</i> 43. <i>Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Malesi e Madhe dhe Bashkia Puke.</i> 44. <i>Dhjetor 2021, një takim me Komunitetin Rom/Egjiptian në Shkodër.!</i> 45. <i>Takim në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër me fokus sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.</i>
Diber	46. 23.03.2021: <i>Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Dibrës.</i> 47. 21.06.2021: <i>Takim me përfaqësues të komunitetit Egjiptian, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Diber në bashkëpunim organizatën jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë”,</i> 48. 23.03.202: <i>Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Dibrës</i> 49. 21.06.2021 <i>Takim me përfaqësues të komunitetit Egjiptian, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Diber në bashkëpunim organizatën jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë”;</i> 50. <i>Takim me Institucionet Vendore në Bashkinë Diber me qëllim forcimin e urave të bashkëpunimit.</i>
Gjirokastrë	51. 23.01.2021 <i>Aktivitet ndërgjegjësues pranë Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë me përfaqësues nga Bashkia Gjirokastrë dhe Shtëpia e të Moshuarve.</i> 52. 19.04.2021, <i>intervista me gazetarin e njohur Christian Eehrschutz nga Televizioni kombëtar publik austriak (ORF).</i> 53. 24.05.2021, <i>Intervistë e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë në portalin “Zëri i Amerikës”</i> 54. Shtator 2021, <i>Takim informues Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë pranë komunitetit Rom dhe Egjiptian në Gjirokastrë</i> 55. 16.02.2021 <i>Intervistë me median locale RTGJ.</i> 56. 02.03.2021 <i>Prezantimi i qendrës me mbështetjen e UND, në fokus grupet vulnerabël, si dhe pjestarët e komunitetit romë dhe egjiptianë.</i> 57. 09.07.2021 <i>Aktivitet pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore me përfaqësues të Ndhmës Ekonomike, përfaqësues të NJVNR Bashkia Gjirokastrë si dhe përfaqësues të komunitetit Romë.</i> 58. 30.09.2021 <i>Takim Promovues me Temë: Monitorimi dhe vlerësimi i Kuadrit Ligjorë dhe politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerzore. (Projekt i zhvilluar nga QNL)</i> 59. <i>Takim në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë</i>
Vlorë	60. Datë 11.03.2021 - <i>Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Vlorës.</i>

61. **Datë 23.03.2021** - Takim me zyren rajonale te Avokatit te Popullit Vlore
62. **Datë 18.04.2021** - Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Vlorës.
63. **Datë 25.05.2021** – Takim me Prefektin e Qarkut Vlore ne kuader te forcimit te bashkepunimit nderinstitucional.
64. **Datë 25.05.2021** - Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve ne ambientet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.
65. **Datë 10.06.2021**, Takim me Zyren Rajonale te Avokatit te Popullit Vlore ne kuader te forcimit te bashkepunimit nderinstitucional.
66. **Datë 16.06.2021**, Aktivitet i përbashkët i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë me organizatën "Qendra Aulona" ne Njesine Administrative Novosele per promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për qytetarët në lidhje me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.
67. **Datë 25.06.2021** – Pjesëmarrje ne ëorkshopin e organizuar nga Instituti për Kontratën Shoqërore me teme “Dënimet alternative - Alternativa për një jetë më të mirë”.
68. **Datë 30.06.2021**, Takim sensibilizues i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë me një grup qytetarësh në Njësine Administrative Llakatund
69. **Datë 30.06.2021-01.07.2021**, Organizimi i një turi vizitash pranë QSHNJPF në Durrës, Fier dhe Vlorë të një trupe gazetarësh nga televizione më zë në Shqipëri, publik dhe private me qëllim promovimin e qendrave.
70. **Datë 13.07.2021** – Takim me Drejtuesin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social ne kuader te forcimit te bashkepunimit nderinstitucional.
71. **Datë 15.07.2021** - Pjesëmarrje ne takimin promovues të metodologjisë së monitorimit “Monitorimi dhe vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore”,
72. **Datë 23.09.2021** - Organizimi i nje tryeze diskutimi me teme “Diskriminimi Racial” midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, përfaqësues të Bashkisë Vlorë, përfaqësues te Shoqatës “Shqipëria” dhe shoqerisë civile.
73. **Datë 27.09.2021** – Pjesëmarrje ne takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë në prezantimin e fazes së dytë të projektit Romacted, i cili ka në fokus promovimin e qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor.
74. **Datë 30.09.2021** – Pjesëmarrje ne takimin promovues të metodologjisë së monitorimit “Monitorimi dhe vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, ne Gjirokaster.
75. **Datë 05.10.2021** - Pjesëmarrje ne takimin sensibilizues dhe ndërgjegjësues për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore organizuar nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me përfaqësues te Zyrës së UNICEF.
76. **Datë 20.10.2021** - Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Vlorës.
77. **Datë 29.10.2021** – Pjesëmarrje ne takimin e orgaznuar në kuadër të Projektit “Lufta kundër Diskriminimit dhe Mbrojtja e të Drejtave LGBTI në Shqipëri”
78. **Datë 04.11.2021** - Takim me Drejtuesin e Agjencise Rajonale te Punesimit dhe Aftesive, ne kuader te forcimit te bashkepunimit nderinstitucional.
79. **Date 05.11.2021** – Pjesëmarrje ne takimin e zhvilluar ne kuader te Keshillit Vendor te Sigurise- Bashkia Vlore referuar problemeve dhe sfidave që kanë të rinjtë në Bashkinë e Vlorë.
80. **Date 19.11.2021** – Pjesëmarrje ne takimin e zhvilluar ne Bashkine Vlore me teme ‘*Akresi i minoritetit Rom në certifikimin e banesave dhe tokës bujqësore të fituar me ligjin 7501*’.
81. Organizimi i nje tryeze diskutimi me teme “Dhuna ne Familje” midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Social Bashkia Vlorë, Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajone e Punesimit, Drejtorisë Vendore të Policisë si dhe Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë

Fier	82. 11.02.2021: Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Fierit. 83. 08.04.2021: Aktivitet “ Dita nderkombetare e Romeve” me qytetaret ne fshatin Mbrostar, Fier. 84. 16.04.2021: Aktivitet “Mbi ndihmën ligjore falas për personat me aftësi të kufizuar ne qytetin e Fierit”, me përfqësues të Bashkisë Fier, UNDP, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe FSHDPAK. 85. 05.05.2021: : Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier ne bashkepunim me KMD organizoi nje takim me teme “ Diskriminimi gjinor ne pune” ku u be edhe nje prezantimmbi ligjin dhe sherbimet qe ofron qendra jone. 86. 25.05.2021: Qendra e Ndiemes Juridike Paresore Fier ne bashkepunim me Qendren Sociale Murialdo zhvilloi nje takim me te rinjt e prinderit te komunitetit rome dhe personat qe jetojne ne banesat sociale ne kuader te promovimit dhe ndergjegjesimit. 87. 28.05.2021, Takim i hapur me qytetarë për promovimin e shërbimi ligjor në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit ,në fashtin Hamil, Fier në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. 88. Tetor 2021: Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier zhvilloi një orë mësimore në bashëpunim me Qendrën Sociale Murialdo. Kjo orë u zhvillua me një grup nxënësish në ambientet e shkollës “Dino Ismaili”, me temë “Trafikimi i qenieve njerëzore”. 89. 11.06.2021, Takim i hapur me qytetarë per promovimin e shërbimit ligjore ne kuadër të "Ditës Botërore kundër Punës së Fëmijëve. 90. 16.06.2021, Aktivitet i përbashkët me përfaqësues të degëve rajonale të Shoqatës së Invalideve të Punes në Shqiperi në qytetin e Fierit dhe Vlorës. 91. 18.06.2021: Takim me perfaqesues te Bashkis Fier dhe UNDP per familjet e rikthyera nga migracioni dhe forcimin e urave lidhese mes aktoreve lokal per kete ceshtje, 92. 30.06.2021-01.07.2021, Organizimi i një turi vizitash pranë QSHNJPF në Durrës, Fier dhe Vlorë të një trupe gazetarësh nga televizione më zë në Shqipëri, publik dhe private me qëllim promovimin e qendrave. 93. 23.09.2021- Takim informues Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier dhe Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Patos 94. 17.09.2021: Takim te zhvilluar me Qendrën Europiane dhe KMD në Lushnje me teme “Ngri zërin kundër gjuhës së urrejtjes!” 95. 05.10.2021: Takim me KMD dhe Qendren Komunitare ne Levan, " Takimi i hapur me qytetaret e komunitetit rome" per menyren e perfitimit te ligjit nr.111/2017 . 96. 12.10.2021: Intervista Televizive e QNJF Fier me TV Kombin 97. 29.10.2021: Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier zhvilloi një orë mësimore në bashëpunim me Qendrën Sociale Murialdo. Kjo orë u zhvillua me një grup nxënësish në ambientet e shkollës “Dino Ismaili”, me temë “Trafikimi i qenieve njerëzore”. 98. 01.11.2021: Takim me z. Myslym Zotaj koridnatorin e " Grupimit te Sindikatave ne Shqiperi". 99. 02.11.2021: Aktivitet ndërgjegjësues, afishim i posterave, fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Fierit 100. 04.11.2021: Qendra e Ndiemes Ligjore Fier organizoi nje takim/aktivitet prane ambienteve te Qendres Sociale Murialdo me studentet e shkolles Profesionale, ku si e ftuar nga ana jone ishte edhe Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi, me teme " Prezantim i ligjit 111/2017 dhe aksesit ne drejtesi qe duhet te kete cdo qytetar" 101. 12 .11.2021: Takim prane Shkolles Bujqesore "Rakip Kryeziu" Fier, në inagurimin e inkubatorit për përpunimin e produkteve bujqësore e cila zhvillohet nga ENGIM në kuadër të projektit RISE-Alb (AID 011864), i financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim – AICS, si dhe nje prezantim I Qendres me pjesmarresit. 102. 19.11.2021: Takimin konsultues në kuadër te projektit “Kujdes dhe Zhvillim në Fëmijërinë e Hershme për Fëmijët Rom në Shqipëri”me aktoret lokal ne qytetin e Fierit
------	--

	103. Ne date 06.12.2021 ora 10:30 zhvilluam nje takim prane Shkolles Industriale "Petro Sota" Fier me pjesmarres stafin petagogjik dhe psikologen e shkolles, ne lidhje me promovimin e qendres dhe prezantimin e ligjit nr.111/2017. 104. 07.12.2021 u zhvillua takimi i organizuar nga paraligjoret dhe Qendres se Fierit, pran Drejtorise Rajonale e Formimit Profesional Publik ne Fier ne kuader te "Promovimit dhe aksesit qe duhet te kete cdo individ per realizimin dhe mbrojtjen e te drejtave ligjore". 105. 07.12.2021 pjesmarres ne Bashkin Patos ne kuader te fushates"16 ditet e aktivizimit kunder dhunes me baze gjinore"si nje nga aktoret e rendesishem ne trajtimin e rasteve te dhunes. 106. 09.12.2021 takim ne "Shtepine e te Moshuarve Fier" me drejtoreshen punonjeseve sociale dhe te 50 te moshuarit ne kuader te "Promovimit dhe aksesit ne perfitimin e ndihmes juridike te garantuar nga shteti. " 107. 10.12.2021 nje takim prane nje Fasonerie ne qarkun e Fierit ne kuader te promovimit per sherbimet e qendres, menyren e perfitimit dhe adresen e kontaktit. 108. Session informues pranë komunitetit rom dhe egjiptian
Pogradec	109. 10.02.2021, Aktivitet në kuadër të "<i>Javës kundër Diskriminimit</i>" në bashkëpunim me zyrën rajonale të Avokatit të Popullit Pogradec Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë. 110. 20.04.2021, Në kuadër të promovimit të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec dhe informimit të qytetarve lidhur me shërbimet që ofrohen u zhvillua intervista pranë televizionit lokal SOT7 111. 02.03.2021, Takim me Shoqatën “Unë Gruaja”, Pogradec cila ka vite që operon si qendër këshillimi për gra dhe vajza të abuzuara. 112. Korrik 2021-Takim informues Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec me aktorë që operojnë në qytetin e Pogradecit 113. Session informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë Bashkisë Pogradec
Lushnje	114. 29.04.2021:Aktivitet ndërgjegjësores, afishim i posterave; fletëpalosjeve dhe informimi i qytetarëve, në qytetin e Lushnjes. 115. Tetor 2021: Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnje në bashkëpunim me Shoqatën e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, Lushnje zhvilluan takimin me temë “Situata e romëve në Bashkinë Lushnje”. 116. 19.08.2021 Aktiviteti me teme "Promovimi i Qeverisjes se mire dhe fuqizimi i komunitetit ne nivel vendor" 117. 01.09.2021. Aktivitet ne kuader te projekteve te UNDP me teme " Situata e komunitetit Rom dhe Egjiptian ne bashkine Lushnje". 118. 05.10.2021 Aktivitet me teme" Ndhima ligjore falas ne sherbim te komuniteteve me nevoja te vecanta" 119. Aktivitet pranë Bshkisë Lushnjë me temë: "Për shërbimet e qeverisjes vendore dhe ndihma ligjore në Bashkinë Lushnje".
Kukës	120. Dhjetor 2021, Session informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë Bashkisë Kukës
Elbasan	121. 09.01.2021 Sesion informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë Bashkisë Elbasan 122. 22.06.2021 Sesion informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë ADISA Elbasan
Korçë	123. 20.09.2021 Sesion informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë
Berat	124. 09.06.2021 organizata " Ne mbrojtje te drejtave te grave urbane dhe rurale- MDG" ne Berat si nje nga iniciatoret dhe pjesemarresit e konsultimeve te vazdueshme me mbeshtetjen e AMSHC, BE dhe KKSHC (ne te cilen jemi pjesemarres) ftoi organizatat e shoqerise civile ne kete qark per te diskutuar me gjeresisht per " Udherrefyesin per Hartimin e Politikes dhe Masave per nje Mjedis Mundesues per Zhvillimin e Shoqerise Civile 2019-2023

5.2 Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut

Përgjatë vitit 2021, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë zhvilluar 5 intervista televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut të listuara si më poshtë vijon:

- Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë në televizionin lokal Televizioni RTSH Gjirokastrë
<https://www.youtube.com/ëatch?v=-t1pUvNx9Lo>
- Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier në televizionin lokal Televizioni TV Kombi
<https://www.youtube.com/ëatch?v=-hD48Bgd8YU>
- Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në televizionin News 24
<https://www.youtube.com/ëatch?v=mËëB2buKQhk>
- Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në televizionin Euronews Albania
<https://www.youtube.com/ëatch?v=hcFcoqTX0PM>
- Realizuar intervista televizive nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në televizionin Top Channel
<https://www.youtube.com/watch?v=YiNTEVbJ8zk>

5.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimpruesë që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Përgjatë vitit 2021, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucionet e tjera që kanë në fokus të tyre mbrojtjen e të drejtave ligjore të qytetarëve është bërë e mundur **nënshkrimi i 9 (nëntë) marrëveshjeve të bashkëpunimit** “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”” dhe konkretisht:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 13/4 prot., datë 07.01.2021, me Organizatën Drejtësi Sociale;
2. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 32 prot., datë 18.01.2021, me Shoqatën “Refleksione”;
3. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 449 prot., datë 26.05.2021, me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër
4. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 498 prot., datë 26.05.2021, me Shoqatën e Invalidëve të Punës;

5. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 808 prot., datë 23.09.2021, me Shoqatën “Shqipëria”, Vlorë;
6. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 808 prot., datë 33.09.2021, me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Patos;
7. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 362 prot., datë 09.04.2021, me Shoqatën “Shtëpi Shprese”;
8. Marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Berat (*Dhjetor 2021*)
9. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 997/1 prot., datë 17.12.2021, me Organizatën Jofitimprurëse MDG Berat (*Dhjetor 2021*)

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve konsiston në bashkëpunimin e palëve sa i përket:

- ✓ Promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- ✓ Shkëmbimit të përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- ✓ Zhvillimit të takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- ✓ Planifikimit dhe organizimit të trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- ✓ Kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.
- ✓ Krijimit të hapsirave të nevojshme në lidhje me publicitetin e ndihmës juridike falas që ofrohet për shtresat në nevojë.
- ✓ Informimit periodikisht nga ana e DNJF, në lidhje me aktet e dala në funksion të ligjit.

6. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

6.1 Bashkëpunimi me Euralius

Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

6.2 Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (bashkëpunimi me ASPA, DHASH dhe UNDP)

Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore

DNJF ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017. Në kushtet kur buxheti i DNJF është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm e punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen për zhvillimin e këtyre trajnimeve. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, përgjatë periudhës Maj-Qershor 2021, u bë i mundur zhvillimi i kursit online “*Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti*” si pjesë e Projektit “Shtrirja e shërbimit të ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri” zbatuar nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC). Kursi online u zhvillua me një kohëzgjatje 18 orë në total ku çdo pjesëmarrës ka pasur mundësinë e coaching individual me trajneren Dr. Nadia Rusi dhe pjesëmarrjen e suksesshme të punonjësve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore. **Me zhvillimin e këtij trajnimi u bë e mundur përmbushja e detyrimit ligjor të trajnimit të detyrueshëm të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.**

Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve; ndërveprimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Dhomat Vendore të Avokatisë si dhe të shkëmbimit të konsideratave, u zhvillua trajnimi i dedikuar për ndihmën juridike dytësore.

Ky trajnim u zhvillua si rezultat si një bashkëpunimi ndërmjet UNDP, ADA, DhAsh, MD dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Trajnimi u konsultua në 2 sessione gjatë të cilave janë diskutuar tema specifike të ndërlidhura me ofrimin e shërbimit, parë kjo dhe nga këndvështrimi i praktikës.

Sessioni i parë i trajnimit u zhvillua më datat 15-16 Prill 2021. Gjatë këtij sessioni trajnimi ofruesit e ndihmës juridike dytësore janë trajnuar specifikisht mbi: Legjislacionin mbi ndihmën juridike dhe rëndësinë e tij edhe në nivel ndërkombëtar; Ligjin për ndihmën juridike dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij; Format e shërbimit të ndihmës juridike dhe subjektet përfitues të shërbimit; Standardet e ofrimit të shërbimit në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Diskutime praktike ndërmjet ofruesve të shërbimit, Dhomave të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Sessioni i dytë i trajnimit u zhvillua më datat 22 dhe 23 Prill 2021. Pas diskutimeve të temave mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, aspektet e dala nga zbatimi në praktikë i ligjit, sessioni i dytë i trajnimit ju dedikua temave të posaçme të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese

të ligjit. Me zhvillimin e këtij trajnimi u bë e mundur përmbushja e detyrimit ligjor të trajnimit të detyrueshëm të avokatëve, ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

6.3 Zhvillimi i Webinareve nga DNJF

Në kuadër të njohjes së ofruesve të shërbimit me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket procedurës së mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit, DNJF ka zhvilluar tre webinare me qëllim diskutimin më në detaje të akteve nënligjore dhe konkretisht:

1. *Webinare me punonjësit e rinj me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në qytetet e Fierit, Dibër, Lezhë dhe Vlorë, (Janar 2021).*
Qëllimi kryesor i këtij Webinari ishte prezantimi i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në terma më konkretë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore.
2. *Trajnim i studentëve të angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (Shkurt 2021)*
Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “*Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.*
Në këtë takim online u trajtuan temat: “*Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë*”.
Në fund të këtij aktiviteti studentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
3. *Trajnim online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” (Mars 2021)* Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Eurlius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

6.4 Trajnimi i paraligjorëve në kuadër të projektit “Angazhimi proaktiv i paraligjorëve në kuadër të forcimit të aksesit në drejtësi për kategoritë vulnerabël”, me mbështetës OSFA

Në kuadër të konkretizimit të bashkëpunimit me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, referuar projektit: “Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, u mbyll me sukses sesi i 4 (katër) trajnimeve të zhvilluara nga specialistët e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Gjatë 4 ditëve u trajtuan këto tema:

- Ndihma juridike parësore;
- Ndihma juridike dytësore;
- Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme;
- Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

7. Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike

7.1 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash.

Në këtë plan janë parashikuar disa masa konkrete që synojnë të mbështesin dhe informojnë komunitetet rome dhe egjiptiane në përputhje me nevojat e tyre. Konkretisht, DNJF ndër të tjera, është përgjegjëse për masat nën objektivat si vijon:

Objektivi Specifik 2.3: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitutional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së.

- 2.3.2 Instrumentet për veprimtaritë dhe bashkëpunimin në fushën e ndihmës juridike falas në nivel qendror dhe nivel vendor, të përmirësuar.
- 2.3.2 a Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC-të, Klinikave të Ligjit për ofrimin e ndihmës juridike falas (kontrata bashkëpunimi).

Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike.

- 4.1.1 Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme.
- 4.1.1 a Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në

gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë (II) Mars 2020: Aktivitet ndërgjegjësues/sesion informues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për të miturit në Institutin e të Miturve Kavajë (përgatitje fletëpalosjesh, broshura informuese dhe manual mbi sistemin e ndihmës juridike në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme) - Brenda vitit 2020: zhvillimi i aktiviteteve/sesioneve të informimit në gjimnaze, duke filluar me qytetin e Elbasani, aty ku është ngritur qendra e ofrimit të ndihmës juridike e duke vijuar me qytetin e Tiranës. (përgatitje e materialeve në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme). Aktivitet ndërgjegjësues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për gratë e dënuara.

- 4.1.1 b Hartimi i materialeve informuese alternative me grafika, simbole dhe shenja të përshtatura me kategoritë e përfituesve dhe aftësitë e tyre për marrjen e informacionit. Aktivitete që vijnë përgjatë kohës së zbatimit të PV.
- 4.1.3 Mekanizma për të përmirësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me median
- 4.1.3 b Realizimi i programacioneve mediatike/ intervistave dhe diskutimeve në TV kombëtare dhe lokale, si dhe në radio nga anëtarët e Rrjetit me tematika të ndryshme ligjore sipas sektorëve përkatës (nr. i programeve RTV me tematika ELP

Objektivi specifik 4.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik.

- 4.2.1 Mekanizma dhe instrumente të lidhura me informimin dhe ndërgjegjësimin publik, të përmirësuar.
- 4.2.1 c Fushata ndërgjegjësuere dhe informuese për ligjin nr.111/2017; broshura dhe fletëpalosje specifike në qytete Tiranë, Durrës, Elbasan, etj) Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV;
- 4.2.1 ç Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj. Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV.

Objektivi specifik 4.6: Rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të studentëve të drejtësisë dhe profesionistëve të së drejtës në ELP.

- 4.6.1 Qytetarët të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, nëpërmjet aktiviteteve me studentë të ligjit dhe avokatë të specializuar.
- 4.6.1 a: Aktivitete të zhvilluara me studentë të shkencave të komunikimit për të ofruar ELP pranë komuniteteve.

Në kuadër të kësaj Strategjie, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton periodikisht çdo tre muaj si dhe sa herë kërkohet në kuadër të Raporteve të Monitorimit. Gjithashtu, Drejtoria ndjek çdo takim dhe trajnim që zhvillohet në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut.

7.2 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND).

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet që garanton aksesin në drejtësi dhe si e tillë ka një kontribut të rëndësishëm në këtë strategji dhe në zbatimin e saj përmes planit të veprimit. Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportim mbi masat e parashikuara në planin aktual të

veprimit në zbatim të kësaj strategjie si dhe me kontribut e sugjerime konkrete mbi procesin e rishikimit të strategjisë.

Në kuadër të kësaj Strategjie, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton periodikisht **çdo tre muaj** si dhe sa herë kërkohet në kuadër të Raporteve të Monitorimit. Gjithashtu, Drejtoria ndjek çdo takim dhe trajnim që zhvillohet në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

7.3 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK).

DNJF ka dhënë kontribut në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë, konkretisht për masën e lidhur me veprimtarinë Task Forcës Antikorrupsion (nën objektivin A.8 të strategjisë).

Gjithashtu, në kuadër të Planit të Veprimit Antikorrupsion, DNJF është angazhuar dhe jep kontribut në kuadër të objektivave A8 dhe A9 lidhur me analizat e vlerësimit të riskut dhe hartimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj Strategjie, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton periodikisht **çdo tre muaj** si dhe sa herë kërkohet në kuadër të Raporteve të Monitorimit. Gjithashtu, Drejtoria ndjek çdo takim dhe trajnim që zhvillohet në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

7.4 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM)

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2017-2020 në Republikën e Shqipërisë është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për tu ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore administrative apo civile, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtave të fëmijëve.

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ka parashikuar të miturit si kategori të veçanta përfituese. Siç paraqitet në aspektin penal, si në çështjet civile ashtu edhe në atë administrative, të miturit në konflikt me ligjin garantohen nga një numër i të drejtave procedurale dhe garancive sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017.

Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportim mbi masat e parashikuara në planin aktual të veprimit në zbatim të kësaj strategjie si dhe me kontribut e sugjerime konkrete mbi procesin e rishikimit të strategjisë.

Në kuadër të kësaj Strategjie, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton periodikisht **çdo tre muaj** si dhe sa herë kërkohet në kuadër të Raporteve të Monitorimit. Gjithashtu, Drejtoria ndjek çdo takim dhe trajnim që zhvillohet në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit.

7.5 Kontribut i DNJF në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP).

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është përfshirë në procesin e hartimit të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur OGP 2020-2022, mbi komponentin nr.3 “Aksesi në Drejtësi”, duke dhënë kontributin me masa konkrete drejtpërdrejtë të lidhura me ndihmën Juridike të garantuar nga shteti.

Në kuadër të këtij procesi, Drejtoria ka ndjekur hap pas hapi të gjitha takimet dhe trajnimet e zhvilluara për këtë qëllim si dhe konsultimet me aktorët e përfshirë në sistemin e ndihmës Juridike në përmbushje të këtyre masave.

8 Angazhimet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të procesit të Integritetit European dhe Raportimeve Ndërkombëtare

DNJF si një institucion i dedikuar sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është angazhuar që prej fillimit të funksionimit në hartimin e kontributeve të vazhdueshme në kuadër të proceseve që ndiqen me Bashkimin Evropian.

1. Kontribut dhe raportime në kuadër të procesit të Integritetit Evropian për progresin e arritur mbi forcimin e aksesit në drejtësi dhe shërbimet ligjore falas:

- Kontributit i Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë (komponenti i ndihmës juridike);
- Kontribut në kuadër të Nën – Komitetit, “Drejtësi, Liri dhe Siguri”;
- Kontribute të tjera të kërkuara në kuadër të progresit të bërë (të dhëna statistikore);
- Kontribut mbi procesin e përafrimit të legjislacionit me *Acquis* e BE;
- Kontribut në kuadër të takimit të Këshillit Kombëtar për Integritetin Evropian me temë: “Progresi i realizuar dhe sfidat në kuadër të Kriterit Politik, Kapitullit 23 dhe 24, me fokusin në 15 pikat e Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 Mars 2020 për hapjen e Negociatave”;
- Kontribut dhe ndjekje e aktiviteteve të zhvilluara nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA).

9 Raportime ndërkombëtare:

Kontribut i përditësuar i DNJF lidhur me zbatimin e Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” CEDAE

Kontributi i Drejtorisë lidhet me përmbushjen e rekomandimeve kryesore që rrjedhin nga kjo Konventë për ndihmën juridike falas, konkretisht: Ndhma juridike parësore; Ndhma juridike dytësore; Ndhma juridike ONLINE; Forcimi i kapaciteteve / trajnime; Publikime / promovimi i sistemit të ndihmës juridike (në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit sa më të gjerë të publikut mbi kushtet / kriteret e përfitimit, ofruesit e shërbimit)

10 Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA:

- Kontribut në kuadër të IPA II

Kontrata sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, synon të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimit të ligjit dhe të ulë korrupsionin në institucionet qeveritare dhe në gjyqësor. Masat e

parashikuara do të kontribuojnë në forcimin e pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri në përputhje me standardet evropiane, si edhe do të rrisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin (penitenciar) e vuajtjes së dënimit.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për sa i përket përbushjes së indikatorit 7 “*Free legal aid services are functional*”, në zbatim të Kontratës Sektoriale “*BE për Reformën në Drejtësi*”, ka përcjellë kontribut si vijon:

- Material përmbledhës mbi ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2019;
- Material përmbledhës mbi ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2020;
- Material përmbledhës mbi ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2021.

Gjithashtu, janë një sërë të tjerë dokumentash të tjerë strategjikë të cilët janë në fazat e para të hartimit / konsolidimit të drafteve, për të cilat Drejtoria ka dhënë në mënyrë të vazhdueshme komente dhe sugjerime të ndërlidhura me aksesin në drejtësi, si vijon:

- Strategjia për personat me aftësi të kufizuar;
- Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027;
- Plani Kombëtar për personat LGBT 2021-2027
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026.

11 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse (UNDP/EURALIUS/OSFA)

11.1 Bashkëpunimi me UNDP

- Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Në mbështetje të Marrëveshjes për zbatimin e projektit, “*Shtrirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri*” midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), si dhe në zbatim të Letrës së Bashkëpunimit (*Korrik 2020-Maj 2022*), është bërë e mundur hapja dhe kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas i 8 (tetë) qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në të cilat ushtrojnë funksionet aktualisht 14 (katërmbëdhjetë) punonjës me trajnim të posaçëm në qytetin e Durrësit, Fierit, Lezhës, Gjirokastrës, Pogradecit, Dibrës, Shkodrës dhe Vlorës. (*informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës*).

-Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Me mbështetjen e UNDP është bërë i mundur zhvillimi i trajnimit të detyrueshëm të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (*informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës*).

11.2 Bashkëpunimi me Euralius

Një ndër partnerët mbështetës të drejtorisë në kuadër të çështjeve të ndihmës juridike falas është EURALIUS, organizatë e cila përgjatë kësaj periudhe është angazhuar në mbështetje të DNJF në zhvillimin e aktiviteteve si vijon:

-Publikimi i Manualit të Ligjit nr.111/2017, dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij

Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë një përmbledhje të koncentruar mbi sistemin e ri të ndihmës juridike dhe udhëzime për zbatimin në praktikë të të gjithë kuadrit ligjor në këtë fushë. Ky manual i është shpërndarë të gjitha Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, Dhomave Vendore të Avokatisë; Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve; Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara; Institucioneve të Pavarura si dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të DNJF.

- Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

11.3 Bashkëpunimi me OSFA

- Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë

Përmes projektit: “Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë” Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, ka administruar qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë deri në muajin Prill 2021, me mbështetjen e Fondacionit OSFA. (*informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës*).

- Projekti “Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”

Sikurse rezulton edhe nga eksperiencia e shteteve e ndryshme, është e nevojshme që ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore të ketë një qasje më proaktive me qëllim identifikimin paraprak të kategorive më në nevojë të cilët hasen me problematika ligjore. Si rrjedhojë, përfshirja e paraligjorëve

në ofrimin e ndihmës juridike është një mundësi mjaft e mirë sa i përket identifikimit të komuniteteve në nevojë si dhe vendosjes së një lidhje me institucioneve shtetërore me komunitetin.

Për këtë arsye, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me fondacionin OSFA është duke implementuar projektin: *“Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”* protokolluar pranë nesh me nr. 583/1 dt. 12.07.2021.

Ky projekt ka për synim rekrutimin e 2 paraligjorëve pranë Qendres së Shërbimit të Ndhmës Juridike Paresore të cilet do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në terren me qëllim evidentimin e komuniteteve (kategori përfituese të ligjit) që kanë nevojë për shërbim ligjor falas si dhe zhvillim e aktiviteteve promovuese/dergjegjesuese.

- *Objektivi nr. 1: Angazhimi i 2 (dy) paraligjorëve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Paresore Tiranë (përfunduar rekrutimi i paraligjorëve)*
- *Objektivi nr. 2: Trajnimi i paraligjorëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (përfunduar trajnimi i paraligjorëve)*
- *Objektivi nr. 3: Krijimi i një rrjeti me paraligjorët e tjerë të angazhuar pranë Organizatave Jofitimprurëse me fokus bashkëpunimin në referimin e rasteve dhe zgjidhjen e problematikave. (zhvilluar takime të vazhdueshme sipas kalendarit të aktiviteteve të përcaktuara në projekt).*

11.4 Bashkëpunimi me OSBE

Takim me fokus fuqizimin e klinikave të ligjit si ofrues të ndihmës juridike paresore, me mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri (Nëntor 2021)

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri zhvilloi në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut tryezën me fokus fuqizimin e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të ndihmës juridike paresore. Në këtë takim vlen të evidentojmë pjesëmarrjen e z. Maclean, Shefi në detyrë i Departamentit të Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut, Zj. Vorpsi, Zj. Bano dhe Z. Kosta, të cilët ndanë me pjesëmarrësit eksperiencat e tyre në fushën e së drejtës dhe sidomos në fushën e ndihmës juridike. Disktuam mbi rolin e Klinikave të Ligjit me përfaqësuesit e Klinikave në kuadër të forcimit të bashkëpunimit, shtrirjen më tej të urave të bashkëpunimit dhe në evidentimin e problematikave dhe mënyrën sesi mund ti zgjidhim ato.

11.5 Kërkesë për mbështetje ambasadave me qëllim forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me qëllim zhvillimin e një takimi të mundshëm për të shkëmbyer konsiderata dhe mundësi bashkëpunimi i është drejtuar ambasadave me shkresat si vijon:

- 1 Shkresa nr. 752 prot., dt. 07.09.2021, drejtuar Ambasadës Norvegjeze në Prishtinë;
- 2 Shkresa nr. 766 prot., dt. 13.09.2021, drejtuar Ambasadës Zviceriane në Shqipëri;
- 3 Shkresa nr. 767 prot., dt. 13.09.2021, drejtuar Ambasadës Holandeze në Shqipëri;
- 4 Shkresa nr. 771 prot., dt. 13.09.2021, drejtuar Prezencës së OSBE në Shqipëri;
- 5 Shkresa nr. 772 prot., dt. 13.09.2021, drejtuar Prezencës së USAID në Shqipëri;
- 6 Shkresa nr. 773 prot., dt. 13.09.2021, drejtuar Prezencës së OKB në Shqipëri;

- 7. Shkresa nr. 878 prot., dt. 02.11 2021, drejtuar Ambasadës Britanike në Shqipëri.

Referuar dhe aktiviteteve të percaktuara në Strategjinë për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti, hartuar në bashkëpunim me Euralius, në vijim parashtrohen disa nevoja për mbështetje për Drejtorië e Ndhmës Juridike Falas

1. **Kryerja e një sondazhi kombëtar mbi nivelin e njohurive të qytetarëve për ndihmën juridike** (shërben me qëllim evidentimin e qytetarëve që kanë nevojë për më shumë aktivitete informuese);
2. **Kryerja e një sondazhi kombëtar me qëllim evidentimin e personave që janë kategori potenciale përfituese nga skema e ndihmës juridike** të garantuar nga shteti (shërben me qëllim evidentimin e raportit midis përfituesve potenciale dhe përfituesve faktike nga skema e ndihmës juridike);
3. **Hartimi dhe publikimi i një Komentari të dedikuar akteve nëligjore në fushën e ndihmës juridike** (shërben për të evidentuar nevojat për ndryshim të akteve nëligjore);
4. **Publikimin e spoteve të shkurtra publicitare për ndihmën juridike në televizionet kombëtare** (menyra me efektive të promovimit të ndihmës juridike);
5. Projekt për mbështetjen e Klinikave të Ligjit (**mbështetja e Klinikave të Ligjit me mjete logjistike (kancelarike) dhe trajnime** të vazhdueshme për studentët)
6. **Konferencë Shkencore “Ndihma Juridike e Garantuar nga Shteti”** (ofruesit e shërbimit, studiuesit e ligjit dhe jo vetëm, do të kenë mundësinë të rrahin mendimet si dhe të publikojnë artikujt e tyre në një botim shkencor të dedikuar ndihmës juridike);
7. **Makina Levizese** (edukimi ligjor i qytetarëve në kuadër të strategjisë për edukimin ligjor të publikut);
8. Mbështetja për **krijimin dhe funksionimin e Komitetit Nderinstitucional për Ndhmën Juridike** me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike (Gjykatat, Prokurori, MD, Dhoma e Avokatise, Dhoma e Vendeve të Avokatise, Aspa, etj) me qëllim hartimin e një Strategjie Komunikimi;
9. **Training Need Analysis** për DNJF, ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike përsore dhe dytesore;
10. **Zhvillimi i trajnimeve vazhdueshme të evidentuara nga Training Need Analysis** për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike përsore dhe dytesore;
11. **Hartimi i një metodologjie për përcaktimin e numrit dhe profileve të avokatëve të nevojshëm për çdo rreth gjyqësor**, duke u mbështetur me indikator tregues të popullatës respektive në raport me kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas;
12. **Përgatitja e materialeve audiovizuale informuese dhe trajnuese për avokatët dhe ekspertët të përfshirë si ofrues shërbimi të ndihmës juridike**, për sa i përket funksionimit të mekanizmit të ndihmës juridike falas dhe procedurave të kryerjes së pagesave;
13. **Përpjekja për të përfshirë në një prej moduleve të kurikulës së Shkollës së Magjistraturës dhe Fakulteteve të Drejtësisë të mekanizmit të ofrimit të ndihmës juridike falas.**

14. **Kontraktimi i një punonjësi me detyrë koordinimin** dhe ndërveprimin institucional me Bashkitë apo institucione të tjera, **për evidentimin e rasteve kur përfituesit e humbasin statusin e tyre si përfitues nga skema e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.**
15. **Asistencë ligjore për adresimin e plotësimeve dhe përmirësimeve ligjore** në mekanizmin e ndihmës juridike falas.

12.1 Prokurimet

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në strukturën e saj, nuk ka një sektor të posaçëm i cili meret me prokurimin e fondeve. Në mungesë të saj, bazuar në Udhëzimin Udhëzimi i APP nr. 3, datë 8.01.2018¹ “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar⁴, titullari i DNJF-së, çdo vit ngre një komision për prokurimet i cili ushtron kompetencat e tij gjatë gjithë vitit kalendarik.

Bazuar në Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrat të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrat të realizimeve të prokurimit dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, gjatë vitit 2021 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për nevojat e saj ka hartuar regjistrin e parashikimeve për prokurimin e fondeve në dispozicion, një kopje të të cilit e ka dërguar në degën e thesarit Tiranë dhe një kopje në Ministrinë e Drejtësisë.

Duke qenë institucion i ri, për vitin 2021 për DNJF-në janë akorduar në dispozicion fonde për investime për dy zëra konkretisht, Investim për pajisje elektronike në vlerën 1.000.000. lekë dhe investim për mobilje zyre në vlerën 1.000.000. lekë. Të dy zërat janë prokuruar dhe në këtë mënyrë janë përmbushur nevojat e drejtorisë për pajisjet e munguara.

Referuar regjistrat të prokurimeve DNJF ka parashikuar një fond prej 4.500.000 lekë pa TVSH të cilat do të plotësonë nevojat e institucionit për funksionimin normal të tij. Nga fondi total, për gjashtëmujorin e parë janë përdorur 1.081.999 lekë e fondit e cila përbën 24% të fondit vjetor në dispozicion.

Gjatë prokurimit të fondeve publike të DNJF-së nuk është administruar asnjë kërkesë apo ankesës të operatorëve ekonomik që pretendon shkeljen e rregullave ligjore, diskriminim apo trajtim të diferencuar të subjekteve çdo procedurë prokurimi është likujduar nga drejtorie e financës brenda afateve ligjore dhe nuk ka detyrime të mbartuar për këtë qëllim.

Të dhëna buxhetore viti 2021

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, për vitin 2021, ka patur si qëllim të tij ofrimin e ndihmës juridike falas për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike, si edhe zbatimin dhe monitorimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për realizimin e këtij

⁴ Shfuqëzuar me udhëzimin e APP Nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”

qëllimi janë përcaktuar 2 objektiva me ndikim në realizimin e fondeve të akorduara në buxhetin e vitit 2021:

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike,
2. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për gratë dhe vajzat, pjesë e kategorisë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike.

Tabela e mëposhtme paraqet fondet e akorduara nga buxheti i shtetit dhe donatorëve dhe realizimin e tyre në vlerë dhe përqindje.

(000 lekë)

Art.	Emertimi	Plani i vitit 2021	Realizimi vitit 2021	Realizimi në përqindje i buxhetit
600	Paga	21.400,0	15.695,4	73,34
601	Sigurime Shoqërore	3.600,0	2.579,2	71,64
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	39.947,0	10.506,9	26,3
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	226,0	24,0	10,6
231	Kapitale te trupezuara	1.000,0	896,9	89,7
	Shpenzime Korrente	66.173,0	29.702,4	44,6
	Te ardhura jashte limiti llogaria 6009999	14.444,4	12.326,4	85,3
	Te ardhura jashte limiti llogaria 6029999	809,5	342,5	42,3
	Shpenzime nga te ardhura jashte limiti	15.253,9	12.668,9	83,05
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)	81.426,9	42.371,3	52,03

Duke iu referuar shifrave për vitin 2021, vihet re një realizim në vlerë prej 29.702.483 lekë të shpenzimeve të fondeve të financuara nga buxheti i shtetit dhe 12.668.853 lekë realizuar nga fondet e dhëna në formë granti për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike në qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë.(gjithsej 8 qendra me financim nga UNDP dhe 2 punonjës paraligjor nga OSFA).

Me financim nga buxheti i shtetit janë miratuar dhe funksionojnë 2 qendra (Lushnje dhe Tiranë).

1. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore:

Fondet e celura nga buxheti i shtetit në vlerën totale **25.000.000 lekë (21.400.000 paga dhe 3.600.000 sigurime shoqërore)** nga të cilat realizuar **18.274.619 lekë** ose e shprehur në përqindje në masën **73,09%**. Arsytet e mosrealizimit të plotë të fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore ka ardhur si rezultat i krijimit të vendeve vakante. Realizimi i këtij buxheti i përket fondit të pagave dhe

sigurimeve për 17 punonjës nga 25 të miratuar në strukturën organizative të organizimit dhe funksionimit të DNJF.

2. Fondi i shpenzimeve për vendimet gjyqësore:

Gjatë vitit 2021 në total janë shlyer detyrimet financiare me objekt “ndihmën juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet” me një kosto prej **5.188.928 lekë**.


3. Fondi për shpenzimet për funksionimin e veprimtarisë së institucionit është realizuar në vlerën **5.318.056 lekë**.

Gjithsëj fondi për llogarinë ekonomike 602(shpenzime operative) është realizuar në masën **26,3%**.

4. Shpenzimet kapitale

Për vitin 2021 Drejtoria e Ndhmës Juridike ka patur buxhet të çelur për investime në vlerën 1.000.000. lekë, prej të cilave janë **realizuar 896.880 lekë (89,7%)**.

➤ Realizimi i fondeve buxhetore sipas grafikut:



Pjesë e buxhetit të vitit 2021 janë edhe fondet e akorduara nga dy organizatat ndërkombëtare UNDP dhe OSFA për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike në qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë.(gjithsej 8 qendra me financim nga UNDP dhe 2 punonjës paraligjor nga OSFA). Fondet e akorduara gjatë këtij viti janë në vlerën **15.253.893 lekë**, me fokus pagesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 8 qendra me nga 2 punonjës, si edhe 2 punonjës paraligjor. Ky fond është realizuar në masën 83,05% në vitin 2021 dhe fondet e mbetura janë mbartuar për përdorim në vitin 2022 në koherencë të zbatimit të akt-marrëveshjeve dhe kontratave me donatorët.

Më poshtë realizimi në formë grafiku i fondeve të akorduar nga donator.

➤ Realizimi i fondeve nga organizatat në formën e granteve sipas grafikut:



PËRFUNDIME

- ✓ **Tashmë DNJF funksionon me kapacitet të plotë dhe staf drejtues të rekrutuar** (Në Shkurt të vitit 2021, është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundur realisht realizimin e këtij objekti në masën 100%. Mbeten vakante 3 (tre) pozicione Specialist, vakanca e të cilave në raport me intensitetin e proceseve të punës ndikon negativisht në kohën dhe cilësinë e proceseve të punës);
- ✓ **Tashmë janë funksionale dhe operojnë dhjetë qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore** (Përgjatë vitit 2021 është bërë e mundur hapja/rivitalizimi i 3 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier, Vlorë dhe Dibrë (me mbështetjen e UNDP);
- ✓ Me Urdhër nr. 396 datë 08.07.2021, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin dhe kalimin nën administrimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas” bëhet i mundur kalimi i Qendrës Tiranë, si qendra e dytë që mbështetet me buxhtin e shtetit;
- ✓ **Numri i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit shkoj në njëmbëdhjetë;**
- ✓ **U nënshkrua marrëveshja e dytë e bashkëpunimit me UNDP** (Korrik-Dhjetor 2021) si dhe u dakordësua për vijimin e mbështetjes dhe për vitin 2022;
- ✓ **U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me OSFA** në kuadër të projektit “Angazhimi proaktiv i paraligjorëve”;
- ✓ **U zhvilluan praktikat 3 mujore të punës të studentëve** të agazhuar në Klinikat e Ligjit pranë DNJF dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- ✓ **U publikua lista përfundimtare e avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021.** (Nënshkruajnë kontratë me DNJF, 124 avokatë);
- ✓ Janë zhvilluar gjatë këtij viti **mbi 125 aktivitete ndërgjegjëse** dhe takime ndërmjet aktorëve të sistemit të ndihmës juridike me fokus promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti (2 fishi i aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2020);
- ✓ Janë lidhur **9 marrëveshje bashkëpunimi** me institucione vendore/ organizata të shoqërisë civile “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”” si dhe **3 marrëveshje bashkëpunimi** “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshtim për hapjen e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore”;
- ✓ Janë zhvilluar **5 intervista televizive** me fokus promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;

- ✓ Është bërë i mundur trajnimi i detyrueshëm ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore si dhe paraligjorëve të angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë;
- ✓ Është dhënë kontributi për raportet e monitorimit për të gjitha strategjitë ku DNJF është e angazhuar (*SND; SDM; SELP; SNKK*).
- ✓ Gjatë këtij viti kanë përfituar **ndihmë juridike parësore 8153 qytetarë** (*2 fishi i rasteve të trajtuara gjatë vitit 2020*)
- ✓ Gjatë këtij viti kanë përfituar **ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 671 persona** (nga 849 vendime gjyqësore në total).
- ✓ **Shpenzimet për pagat (600)** janë realizuar në vlerën 15.695.365 dhe shuma prej 2.579.254 lekë sigurimet shoqërore (601), janë realizuar në masën 73,09% kundrejt planit fillestar të buxhetit të shtetit.
- ✓ **Shpenzimet operative (602)**, janë realizuar, në total në vlerën 10.506.984 lekë ose në masën 26,3% kundrejt planit fillestar të buxhetit të shtetit.

Vështrim krahasimor

Arritjet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas 2020- 2021

	Arritjet për çdo objektiv	2020	2021
1	Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas	Vakanca për 3 Drejtorët e Drejtorive të Ndhmës Juridike Falas	Është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundësuar kështu realizimin e këtij objektivi në masën 100%. Vakanca për 3 (tre) specialistë të DNJF Është propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë nisja e procedurave për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore si pjesë e strukturës së DNJF, për të bërë të mundur vijimin e ofrimit të shërbimeve dhe pas përfundimit të mështetjes së UNDP
2	Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 111/2017	3 akte të pamiratuara, konkretisht: - Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020 për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore. - Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr.17, datë 5.8.2020 Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve, që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative - Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas	Është bërë i mundur miratimi i të gjithë paketës së akteve nënligjore duke mundësuar kështu realizimin e këtij objektivi në masën 100%. Janë evidentuar nevojat për ndryshime të ligjit dhe akteve nënligjore pëcjellë Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 930 prot., datë 25.11.2021

3	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga qendrat të shërbimit të ndihmës juridike parësore	7 qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore të hapura në qytetin e Tiranës, Lushnjes, Pogradecit, Shkodrës, Lezhës, Gjirokastrës dhe Durrësit.	10 Qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore Hapen 3 qendrat e reja në Vlorë, Dibër dhe Fier
4	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	9 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	11 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë Universitetit Marin Barleti dhe Universitetit Luarasi
5	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga organizatat jofitimprurëse	Është bërë i mundur autorizimi i 12 organizatave jofitimprurëse aplikuese për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Në proces financimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore.	Në proces financimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Është bërë i mundur hartimi i metodologjisë së financimit për thirrjen e vitit 2022
6	Ofrimi i ndihmës juridike dytësore nga avokatët	Për vitin 2021 kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore 60 avokatë	Dyfishohet numri i avokatëve që kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021, në 124 avokatë
7	Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes	Realizuar 4 monitorime të qëndrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.	Realizuar monitorimi tre mujor i 10 qëndrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore;
8	Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura	Zhvilluar 60 takime/aktivitete ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura	Zhvilluar 125 takime/aktivitete ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura
9	Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	Në proces	Përfunduar trajnimi i detyrueshëm të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

10	Raste të trajtuara, ndihma juridike parësore	4191 raste të trajtuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristionline dhe numri i gjelbër 08001010	2-fishohet numri i rasteve të trajtuara në 8153 raste të trajtuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristionline dhe numri i gjelbër 08001010
11	Raste të trajtuara, ndihma juridike dytësore	181 vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	4 fishohet fishohet numri i vendimeve gjyqësore në 849 vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore
12	Realizimi Buxhetor Fonde Buxhetore: Fonde Jobuxhetore:	17.139.586 leke 2.512.908 leke	29.702.483 leke 12.668.853 leke

Plani i Punës së DNJF (Janar-Dhjetor 2021)

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS PLAN PUNE

Janar-Dhjetor 2022

Plani i punës Janar-Dhjetor 2022, përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë si dhe dokumentat strategjikë në të cilat DNJF është e përfshirë.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2022, është plani i tretë i miratuar që nga fillimi i funksionimit të DNJF. Ky dokument është kontribut dhe ka për objekt veprimtarinë e të tre Drejtorive përbërëse të DNJF. Ky plan është një dokument pune i cili shërben si udhëheqës në realizimin e objektivave institucionale përmes përcaktimit të masave dhe aktiviteteve konkrete.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2022, përmbledh detyrimet funksionale, përpilimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9936, dtë 26.06.2008 për “Zbatimin e Sistemit Buxhetor në RSH” i ndryshuar si dhe Udhezimit plotësues nr. 4, datë 29.01.2021 për “Zbatimin e Buxhetit të vitit 2021” duke synuar zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare si dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2022, parashikon **15 objektiva të strukturuar** si vijon:

1. Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike parësore;
2. Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore;
3. Monitorimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore;
4. Ndërveprimi me donatorët dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas;
5. Dhënia e kontributit të DNJF në kuadër të dokumentave strategjike dhe procesit të të integritetit evropian;
6. Informimi dhe promovimi mbi sistemin e ndihmës juridike;
7. Raportime mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
8. Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike;
9. Ndjekja e Action Plan në zbatim të Strategjisë për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti;
10. Riallokimi dhe detajimin i fondeve të buxhetit vjetor;
11. Hartimi i raporteve financiare në kuadër të granteve/projekteve në bashkëpunim me Organizatat Ndërkombëtare;
12. Mirëadministrimi i Burimeve Njerëzore;
13. Prokurimi i fondeve publike;
14. Hartimi i regjistrit të riskut, formularët e vetëvlerësimit si dhe Plani i veprimit për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin
15. Analiza e buxhetit si dhe mbyllja e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021

OBJEKTIVI I: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
1.1	Lidhja e marrëveshjes së re të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP (Shkurt 2022-Janar 2023)	Ndërmarrja e procedurave në kuadër të lidhjes së marrëveshjes së re të bashkëpunimit	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.	Shkurt 2022
1.2	Administrimi i qendrave aktuale të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore	Mbarëvajtja e veprimtarisë së qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes: - Komunikimit ditor me punonjësit e qendrave; - Administrimit të të dhënave të shërbimit të ofruar; - Adresimit dhe përcjelljes së çdo problematike të punonjësve të qendrave; - Zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit të qendrave; - Mirëfunksionimit të qendrave përmes pajisjeve me mjetet e nevojshme logjistike.		Process në vijimësi
1.3	Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të 2 nga 8 qendrat e hapura me mbështetjen e UNDP			6 mujori i parë i vitit 2022
1.3	Hapja e 4 qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore	Ndërmarrja e procedurave në kuadër të kalimit nën		6 mujori i parë i vitit 2022 (2 qendra)

		administrim të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Durrës dhe Shkodër Ndërmarrja e procedurave në kuadër të hapjes së 2 të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore përmes: - Komunikimit me institucionet e nivelit vendor, ADISA dhe Gjykatat në kuadër të vendosjes në dispozicion të ambienteve pa kundërshtim për funksionimin e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; - Hapjes së thirrjes dhe marrjes pjesë në procedurat e rekrutimit të punonjësve të rinj - Komunikimit me UNDP në kuadër të pajisjes së qendrave të reja me mjetet e nevojshme logjistike dhe të vizibilitetit; - Trajnimit të punonjësve të rinj mbi kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike dhe mënyrën e raportimit pranë DNJF		6 majori i dytë i vitit 2022 (2 qendra)
1.4	Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga	- Komunikimi me përfaqësuesit organizatave	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe	

1.5	Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara Hapja e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë	jofitimprurëse të autorizuara; - Administrimi i të dhënave të shërbimit të ofruar; - Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti - Zhvillimi i takimeve me OJF që kanë shprehur interes për aplikim në kuadër të sqarimit të procedurës së aplikimit dhe vlerësimit sipas metodologjisë së financimit; - Marrja pjesë në komisionin e vlerësimit dhe ankimit për financimin e OJF-ve - Ndërmarrja e procedurave për lidhjen e kontratave me Organizatat e shpallura fituese	Administrimit të Ndihmës Parësore.	Process në vijimësi 6 mujori i parë i vitit 2022
1.6	Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit	Ndërveprimi aktiv mes DNJF dhe Klinikave të Ligjit me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimit përmes:	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.	Zhvillimi i trajnimeve dhe praktikave të punës për studentët e

1.7	Lidhja e marrëveshjes së 12 të bashkëpunimit me Universitetin Epoka	- Trajnimit mbi ndihmën juridike për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Praktikave të punës për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Zhvillimit të aktiviteve të përbashkëta ndërgjegjësuere/informuese. Ndërmarrja e procedurave në kuadër të lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit		angazhuar 6 mujori i parë i vitit 2022 Zhvillimi i aktiviteve të përbashkëta ndërgjegjësuere/informuese- Proces në vijimësi 6 mujori i parë i vitit 2022
1.8	Administrimi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore	- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi ndihmën juridike parësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike parësore - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike parësore (<i>analizë që hartohet çdo muaj</i>)	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.	Proces në vijimësi <i>Të dhëna mbi baza mujore</i>
OBJEKTIVI 2: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
2.1	Sigurimi i shërbimit të avokatëve	- Vijimi i shërbimit të ndihmës juridike dytësore nga avokatët	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Proces në vijimësi Zhvillimi i trajnimeve/Lidhja e

		- Lidhja e kontratës me avokatët për vitin 2022 si dhe publikimi i listës - Zhvillimi i trajnimeve për avokatët mbi mekanizmin e ndihmës juridike si dhe informimit mbi procedurat e kryerjes së pagesave		kontratës-Mars 2022
2.2	Administrimi i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore	- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike dytësore për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore; - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike dytësore (analizë që hartohet çdo muaj)	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Proces në vijimësi <i>Të dhëna mbi baza mujore</i>
2.3	Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore	- Komunikimi me Dhomat Vendore të Avokatisë në kuadër të caktimit të avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore; - Ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifat gjyqësore.	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Proces në vijimësi <i>Të dhëna mbi baza mujore</i>
78				

		- Hartimi i një materiali përmbledhës për ndihmën juridike dytësore, në të cilin të përfshihen: konstatime e problematika dhe përpjekjet e bëra nga DNJF për të adresuar drejt problematikat dhe për të gjetur mundësi e rrugë të reja bashkëpunimi.		
OBJEKTIVI 3: MONITORIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE/DYTËSORE				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
3.1	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve- Janar 2022 Kryerja e monitorimeve- Proces në vijimësi
		Kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore		
		Monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat; dërgimi i raporteve mujore narrative mbi ecurinë e punës ⁵		
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		
3.2	Monitorimi i shërbimit të ofruar	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes	

⁵ Sipas **formatit narrativ të hartuar** mbi bazën e të cilit qendrat kanë vijuar të dërgojnë të dhënat mbi ecurinë e punës dhe veprimtarinë mujore.

	nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore	Kryerja e monitorimit fillestar për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës Hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse		Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve-Janar 2022 Kryerja e monitorimeve-Proces në vijimësi
3.3	Hartimi i raporteve përmbledhëse të monitorimit	Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike parësore; Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike dytësore.	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Proces në vijimësi
3.4	Kryerja e pagesave për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike	Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike dytësore të ofruar	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Proces në vijimësi
OBJEKTIVI 4: NDËRVEPRIMI ME DONATORËT DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente

4.1	Ndërveprimi me UNDP në kuadër të projekteve të përbashkëta	Ndërmarrja e masave të nevojshme për plotësimin e nevojave logjistike të qendrave të hapura me mbështetjen e UNDP; Ndërveprimi në kuadër të promovimit të qendrave përmes publikimit të spoteve informuese; materialeve të vizibilitetit etj. Ndëveprimi lidhur me aktivitete të përbashkëta me fokus krijimin e netëorkut ndërmjet ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe institucioneve të pushtetit vendor/qendror.	DNJF UNDP	Proces në vijimësi
4.3	Ndjekja e proceseve të punës me OSFA në kuadër të projekteve të përbashkëta	Raportimi i fazës së parë të projektit: “ <i>Angazhimi proaktiv i paraligjorëve</i> ”	OSFA Drejtoria e Financës Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar 2022
		Ndërveprimi në kuadër të funksionimit/promovimit të shërbimit të ndihmës juridike online (juristionline.al) Ndërveprimi në kuadër të funksionimit/promovimit të shërbimit të ndihmës juridike përmes numrit të gjelbër 08001010 - Dërgimi i letrave të interesit; - Evidentimi i nevojave për mbështetje;	OSFA Drejtoria e Zbatimit të Politikave DNJF	Proces në vijimësi Proces në vijimësi
4.4	Bashkëpunimi me mbështetës të tjerë potencialë si OSBE/ Ambasadat			

		- Zhvillimi i takimeve në kuadër të bashkëpunimit; - Ndërmarrja e procedurave të bashkëpunimit në rast dakordësie		
OBJEKTIVI 5: DHËNIA E KONTRIBUTIT DHE RAPORTIMI I DNJF NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN/STRATEGJIVE				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës (Personat përgjegjës)	Afate / komente
5.1	Raportime në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe Konventave Ndërkombëtare/Strategjive	- Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP). - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK) - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM) - Kontribut i DNJF në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP) - Angazhimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe Raportimeve Ndërkombëtare	Drejtoria e Zbatimit të Politikave Drejtoria e Financës	Proces në vijimësi

		- Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA		
OBJEKTIVI 6: PROMOVIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
6.1	Përgatitja dhe ndjekja e publikimeve të DNJF në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Facebook, instagram	Ndjekje e procedurave të nevojshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.	DNJF	Proces në vijim
6.2	Përditësimi i faqes ëeb të DNJF	Përditësimi dhe publikimi i të dhënave më të fundit sipas rubrikave të mirëpërcaktuara.	DNJF	Proces në vijim
6.3	Zhvillimi i takimeve promovuese/sensibili zuese/ edukimit ligjor të publikut	- Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit; - Zhvillimi i ëëbinareve me fokus promovimin/informimin mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti - Zhvillimi i sesioneve informuese mbi aksesin në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	DNJF Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore	Proces në vijim <i>(Referuar Kalendarit të Aktiviteteve të miratuar për këtë qëllim)</i>
6.4	Hartimi dhe publikimi i	- Hartimi i manualeve të thjeshtëzuara me fokus	DNJF	Proces në vijim

	materialeve të vizibilitetit	specifik kategoritë e veçanta përfituese të ligjit.		
OBJEKTIVI 7: RAPORTIME MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
7.1	Përgatitja e raportimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti ⁶	- Hartimi i raportimeve mujore; 3 mujore; 6 mujore dhe vjetore drejtuar Ministrit të Drejtësisë; - Hartimi i raportimeve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë në varësi të kërkesave	DNJF	Prill 2022 (raport 3 mujor) Qershor 2022 (raport 6 mujor) Janar 2022 (raporti vjetor për vitin 2021)
7.2	Trajtimi i shkresave nga institucione të ndryshme në kuadër të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti	Dhënia e informacionit mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti lidhur me kërkesat për informacion	DNJF	Proces në vijim
OBJEKTIVI 8: MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
8.1	Vlerësimi i kostove dhe planifikimi i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike	Ndjekja, analizimi dhe planifikimi i shpenzimeve financiare mbi sistemiin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.		Proces në vijim

⁶ Sipas përcaktimeve të Ligjit nr.111/2017.

8.2	Menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike	Menaaxhimi i fondeve buxhetore të DNJF dhe hartimi i raportimeve financiare		Proces në vijim
OBJEKTIVI 9: NDJEKJA E ACTION PLAN NË ZBATIM TË STRATEGJISË PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI.				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
9.1	Analizë e nevojave për trajnim	- Pyetësor mbi nevojat për trajnim për: 1. Stafin e DNJF; 2. Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore; 3. Ofruesit e Shërbimit të Ndihmës Juridike Dytësore	DNJF Dontatorë	Në varësi të mbështetjes nga donatorët
9.2	Kryerja e një studimi mbi personat në pamundësi financiare/kategori të veçanta sipas ligjit nr. 111/2017, në RSH në raport me numrin e kërkesave për ndihmë juridike	- Draft paraprak mbi qëllimin e studimit dhe rëndësinë e gjetjeve të këtij studimi për DNJF; - Bashkëpunimi me Euralius si partner mbështetës në hartimin dhe zbatimin e strategjisë	DNJF Donatorë	Në varësi të mbështetjes nga donatorët
9.3	Krijimi i një Komiteti Ndërinstitucional për Ndihmën Juridike (me Sekretariat Teknik pranë DNJF)	- Ngritja e Komitetit Ndërinstitucional nga ana e Ministrit të Drejtësisë	DNJF MD Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë Gjykatat	Në rast se miratohen ndryshimet e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

**OBJEKTIVI 10 : RIALOKIMI DHE DETAJIMIN I FONDEVE TË BUXHETIT VJETOR
RAPORTIME;**

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
10.1	Detajimi i fondeve të Buxhetit për vitin 2022	Rialokimi i fondeve të papërdorura me financim nga donatorët sipas strukturave buxhetore si dhe sipas nevojave të institucionit	Drejtoria e Financës	Janar 2022 Deri me 21. Janar 2022
		Pasqyrimi në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe shpallja në faqen zyrtare të APP dhe Institucionit të ndryshimeve		
		Realizimi i likuidimit të detyrimeve të prapambetura me prioritet		

OBJEKTIVI 11: HARTIMI I PAGESAVE TË PUNONJËSVE TË DNJF NGA STRUKTURAT E BUXHETIT TË SHTETIT DHE NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.1	Hartimi i dokumentacionit financiar, për pagat sigurimet dhe shpenzimet	Hartimi i pagesave të pagave të punonjësve të NDJF si dhe punonjësit e qëndrave të sponsorizuar nga OJF	Drejtoria e Financës	Cdo muaj
		Hartimi i Urdhër Shpenzimeve për shpenzimet financiare të artikujve 600 dhe 601		
		Deklarimi i sigurimeve shoqërore shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat		
		Pasqyrimi në sistemin HRMIS të pagave të punonjësve		
		Hartimi i listëprezencës së punonjësve		
11.2	Urdhër Pagesat	Gjenerimi nga sistemi HRMIS i Urdhër Shpenzimeve	Drejtoria e Financës	Cdo muaj

		Transfertat bankare sipas Bankave të nivelit të dytë		
		Pasqyrimi i shtesave, ndalesave apo cdo vendim gjyqësor		
		Sistemi AFMIS, paraqitja e dokumentacionit justifikues të shpenzimit dhe ngarkimi në sistem		
OBJEKTIVI 12: MIRËADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE REKRUTIMI I PUNONJËSVE				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
12.1	Evidentimi i nevojave për kualifikimin e punonjësve	Evidentimi i kualifikimeve të punonjësve Hartimi i planit vjetor të zhvillimit profesional të BNJ	Drejtoria e Financës ASPA	Proces në vijimësi
12.2	Vendet vakante	Evidentimi dhe raportimi i vendeve vakante në zbatim të strukturës së miratuar për institucionin Shpallja e vendeve vakante ne Sitemin HRMIS për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil Percaktimi i përshkrimit të punës dhe përcaktimi i kriterëve për kualifikim në procedurën e rekrutimit të punonjësve Shpallja në faqen Zyrtare të DNJF për vendet vakante, Ngritja e Grupit të punës për pranimin ose skualifikimin e kandidatëve	Depar tamenti Administratë s Publike Drejt oria E financë Buri met Njerëzore	Brenda 6 mujorit të parë për 2022
12.3	Dosjet elektronike të punonjësve	Përditësimi i dosjeve elektronike për punonjësit e DNJF dhe Qendrave të Shërbimit Parësor	Burimet Njerëzore	
OBJEKTIVI 13: PROKURIMI I FONDEVE PUBLIKE				

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente
13.1	Evidentimi i nevojave të institucionit për bazë materiale, shërbime etj	Kërkesat e Drejtorive për t'u pajisur me Bazë Materiale dhe shërbime në funksion të veprimtarisë së Institucionit	Drejtoritë	Sipas nevojave të Drejtorive dhe Qendrave Brenda 6 muajve të parë për 2022
13.2	Prokurimi i Fondeve	Hartimi i Urdhrit të Prokurimit Hartimi i Ftesës për Ofertë Specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve Dokumentimi në sistemin e Prokurimit Publik Realizimi i kontratës	Drejtorja e Financës Komisioni i Prokurimit	Brenda 6 muajve të parë për 2022
OBJEKTIVI 14: HARTIMI I REGJISTRIT TE RISKUT, FORMULARET E VETËVLERËSIMIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN				
14.1	Hartimi i regjistrit të riskut	Ngritja e grupit të punës për hartimin e regjistrit të riskut	Grupi i punës Drejtorja e Financës	Janar-Shkurt 2022
14.2	Hartimi i formularit të vetëvlerësimit për institucionin	Hartimi i formularit të vetëvlerësimit për periudhën janar- Dhjetor 2021 dhe përcaktimi i performancës së institucionit	Drejtorja e Financës Grupi i punës	Janar-Shkurt 2022
14.3	Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF	Rritja e numrit të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore nën administrim të DNJF		

				Gusht-Dhjetor 2022
OBJEKTIVI 15: ANALIZA E BUXHETIT SI DHE MBYLLJA E PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR 2021				
15.1	Pasqyrat financiare për vitin 2021	Plotësimi i pasqyrave financiare për vitin 2021, sipas formatit standart të miratuar nga Ministria e Financës	Drejtoria e Financës	Shkurt – 31 Mars 2022
15.2	Inventarët fizikë dhe kontabël	Kryerja e inventarëve fizik dhe kontabël për aktivet e institucionit	Drejtoria e Financës	Janar 2022
15.3	Amortizimi i pajisjeve	Amortizimi i pajisjeve objekt inventari të DNJF-së Pasqyrimi i vlerave në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.	Drejtoria e Financës	Janar 2022